Raporti Vjetor 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Veprimtaria e KMD është udhëhequr nga legjislacioni në fuqi dhe Plani Strategjik 2018-2021.

Robert Gajda, Komisioner

1/3/2019

PËRMBRAJTJA

Mesazhi i Titullarit ..... faqe 3

Hyrje .....faqe 4

Kapitulli I
Kuadri ligjor mbi barazinë dhe diskriminimin .....faqe 5-27

Kapitulli II
Veprimtaria për mbrojtjen nga diskriminimi dhe promovimin e barazisë ..... faqe 28-82

Kapitulli III
Aspekte të shërbimeve .....faqe 83-85

MESAZHI I TITULLARIT

Në datën simbolike të 1 Marsit që korrespondon me Ditën Ndërkombëtare të Diskriminimit Zero, veshur me funksionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, po Ju dërgoj përmbledhjen vjetore të veprimtarisë së Institucionit e cila reflekton edhe gjëndjen e diskriminimit në Republikën e Shqipërisë.

Nisur nga përpjekjet e vazhdueshme të Kuvendit të Shqipërisë dhe vullnetit pozitiv të treguar në përforcimin e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me qëllim garantimin sa më efektiv të Parimit të Barazisë dhe mbrojtjen e qytetarëve nga diskriminimi individual dhe i strukturuar, uroj një vazhdimësi të përhershme dhe të përditshme të këtij impenjimi të Kuvendit me të gjitha institucionet në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Sfidat janë të gjithanshme dhe kërkojnë një aktivizëm të të gjithë aktorëve publikë dhe shoqërorë në promovimin, garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave sociale, si instrumente vitale në gëzimin me dinjitet të të gjitha të drejtave të njeriut të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventave Ndërkombëtare.

Shpreh besimin e plotë në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e të gjithë subjekteve në ndreqjen e pabarazive dhe luftën kundër diskriminimit, duke garantuar përfshirjen pa rezerva të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në këtë sfidë dhe detyrë publike dhe qytetare.

Uroj hapjen e merituar të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

KOMISIONERI

ROBERT GAJDA

HYRJE

Bazuar në ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) është autoriteti përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

KMD e mbështet veprimtarinë e tij në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

Veprimtaria vjetore e KMD është udhëhequr edhe nga Plani Strategjik 2018-2021, i cili përbën një instrument të rëndësishëm, ku përcaktohen vizioni, misioni dhe objektivat strategjik, dhe Plani Veprimit për vitin 2018. Vizioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është:

"Të jetojmë në një shoqëri ku promovohen parimet e barazisë, mundësitë dhe shanset e barabarta".

Në zbatim të nenit 26, të Ligjit Nr 10 221 datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", ku përcaktohet se "Komisioneri paraqet raport të paktën një herë në vit përpara Komisioneve të Kuvendit. Raporti përfshin analizë për zbatimin e këtij ligji në përgjithësi, si dhe për punën e Komisionerit dhe të zyrës", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka përgatitur dhe paraqet përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "**Raportin Vjetor mbi veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2018".**

Vlerësimet dhe rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë përmes *"Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) për vitin 2017",* kanë përbërë një udhëzues në veprimtarinë e institucionit për garantimin e barazisë dhe mbrojtjes efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që e nxit diskriminimin.

Gjithashtu, Manuali i monitorimit vjetor dhe periodik i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përmes Vendimit Nr. 134/2018, ka shërbyer për hartimin e këtij Raporti Vjetor të KMD, si institucion i pavarur i krijuar me ligj, në kuadër të kontrollit parlamentar.

Raporti Vjetor i KMD për vitin 2018 synon të informojë dhe raportojë mbi veprimtarinë konkrete institucionale të realizuar gjatë kësaj periudhë, përmes 3 kapitujve përbërës, të hartuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

KAPITULLI I

KUADRI LIGJOR MBI BARAZINË DHE ANTIDISKRIMINIMIN

I.1. Aktet Ndërkombëtare në Fushën e të Drejtave të Njeriut dhe Antidiskriminimit

Ka standarde të shumta në këtë fushë të krijuara dhe zbatuara në nivelin e Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës, dhe Bashkimit Evropian, të cilat mund të shërbejnë si bazë e dobishme për çdo vlerësim të pjesëve të kuadrit ligjor të barazisë dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. Pas nënshkrimit dhe ratifikimit të instrumenteve të legjislacionit ndërkombëtar që merren me të drejtat e njeriut dhe pas ndalimit të instrumenteve të diskriminimit, Shqipëria i ka bërë ato pjesë të rendit të brendshëm ligjor.

I.1.1 Instrumentet në kuadrin e OKB-së

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) e vitit 1948, ndonëse ka karakter thjesht deklarativ, pra konsiderohet si një dokument "soft law", ka një vlerë kolosale për formulimin dhe zbatimin e konventave ndërkombëtare, formulimin e ligjeve të çdo shteti, të politikave, veprimeve të autoriteteve dhe individëve si edhe vendimeve të gjykatave.

DUDNJ, në nenin 1, nënvizon se: "*Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta...*". Neni 2/1 parashikon se secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër". Në nenin 7 kemi "të drejtën për barazi përpara ligjit", ku parashikohet shprehimisht se "*Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji .Të gjithë kanë të drejtën për t'u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cenon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë*".

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike është nënshkruar në vitin 1966 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1976. Ky pakt, i ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1991[1], parashikon parimin e barazisë para ligjit dhe të drejtën për mbrojtje të barabartë nga ligji, pa asnjë diskriminim. Ky pakt ka sanksionuar në përmbajtjen e tij se: "*Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet*

[1] Ligj nr. 7510 date 08.08.1991

të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinioni tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo situate tjetër".

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore është nënshkruar në vitin 1966 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1976. Shqipëria e ka ratifikuar Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në vitin 1991.[2] Ky pakt ka sanksionuar detyrimin e shteteve palë për të garantuar ushtrimin e të drejtave të shprehura në të, pa asnjë diskriminim për shkak të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik apo tjetër, origjinës kombëtare ose sociale, pasurisë, lindjes, ose ndonjë statusi tjetër.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD)[3] është miratuar në 13 dhjetor 2006 dhe ka hyrë në fuqi me 3 maj 2008. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në vitin 2012[4]. Bashkimi Evropian e ka ratifikuar këtë Konventë në Dhjetor të vitit 2010.

KDPAK ndalon diskriminimin ndaj kujtdo për shkak të aftësisë së kufizuar, duke marrë në konsideratë faktin që diskriminimi pengon njerëzit të gëzojnë të drejtat e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët. Konventa parashikon edhe hapat që duhen ndërmarrë për të siguruar përshtatjen e arsyeshme, ndaluar diskriminimin de facto dhe forma diskriminuese që mund të shfaqen në të ardhmen, si dhe për të promovuar të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta me të tjerët. Ndalimi i diskriminimit, përveç se një e drejtë e veçantë, është edhe një nga parimet bazë të Konventës që udhëheq interpretimin dhe zbatimin e të drejtave të tjera të mbrojtura në të. Dispozitat e tjera shpjegojnë çfarë përbën diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar në fushat e përkatëse, si dhe masat, përfshirë edhe ato pozitive, për të arritur barazinë në praktikë. Konventa sqaron se këto masa pozitive nuk duhet të konsiderohen si diskriminuese. Po kështu, kuadri kundër diskriminimit plotësohet edhe nga Nenet 6 dhe 7 që kanë të bëjnë me masat anti diskriminuese për fëmijët dhe gratë me aftësi të kufizuara.

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)[5], u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 18 Dhjetor 1979 dhe hyrë në fuqi më 1981. Shqipëria ka ratifikuar CEDAW-n në vitin 1993.[6] Ndërsa Protokolli Fakultativ i Konventës mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, i vitit 1999 i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2000, është ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh në vitin 2003[7]. Në preambulën e saj, Konventa ka përcaktuar se diskriminimi ndaj grave shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe të respektimit të dinjitetit njerëzor, pengon pjesëmarrjen e grave, në të njëjtat kushte me burrat, në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të vendeve të tyre, pengon ngritjen e mirëqenies së shoqërisë e të familjes, dhe vështirëson më tepër zhvillimin e potencialeve të

[2] Ligj Nr. 7511 date 08.08.1991
[3] Convention on the Rights of Persons with Disabilities
[4] Ligji Nr. 108 datë 15.11.2012
[5] Convention on the Elimination of all forms of Discrimination Against Women
[6] Ligji 1769/ 9.11.1993
[7] Ligj Nr. 9052, date 17.04.2003

grave në shërbim të vendeve të tyre dhe njerëzimit, Konventa ka përcaktuar në nenin 1 të saj kuptimin e termit "diskriminim ndaj grave" si çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e gjinisë, e që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë¸ ose të shfuqizojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga statusi i tyre martesor, mbi bazën e barazisë së burrave dhe të grave, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër. Në këtë Konventë sanksionohet mbrojtja nga diskriminimi ndaj grave nëpërmjet masave të përkohshme të veçanta që synojnë përshpejtimin *de facto* të barazisë midis burrave dhe grave; si dhe masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave me qëllim që t'i sigurohen atyre të drejta të barabarta me burrat në fusha të ndryshme si: në jetën politike dhe publike të vendit; në fushën e arsimit; në fushën e punësimit; për të parandaluar diskriminimin ndaj grave për shkaqe martesore apo amësie, dhe për të siguruar të drejtën e tyre efektive për punë; në fushën e kujdesit shëndetësor për t'u siguruar, mundësitë për të përfituar shërbime mjekësore, duke përfshirë edhe ato të planifikimit familjar; në fushat e tjera të jetës ekonomike dhe shoqërore, si dhe masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe me marrëdhëniet familjare.

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, e miratuar në vitin 1966 dhe hyrë në fuqi në vitin 1969, ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1993[8], ka përcaktuar në Preambulën e saj se "*të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe se kanë të drejtë të mbrohen në mënyrë të barabartë nga ligji kundër çdo diskriminimi si dhe kundër çdo nxitjeje për diskriminim*".

Sipas kësaj Konvente, "diskriminimi racial" nënkupton çdo dallim, përjashtim, kufizim, ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare e etnike, që ka për qëllim apo për efekt të shkatërroje ose të kompromotojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në kushte barazie, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushat politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore ose në çdo fushë tjetër të jetës publike. (neni 1)

Konventa përcakton detyrimin e shteteve palë të ndalojë dhe të eliminojnë diskriminimin racial në të gjitha format e tij dhe të garantojë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit pa dallim race, ngjyre ose origjine etnike ose kombëtare, sidomos lidhur me gëzimin e këtyre të drejtave: Të drejtat politike ku përfshihen kryesisht: e drejta e pjesëmarrjes në zgjedhje, e drejta e votimit apo e drejta për të qenë kandidat, dhe për të pasur hyrje të barabartë në shërbimet publike. Të drejtat e tjera civile ku përfshihen kryesisht: e drejta e lëvizjes së lirë dhe e zgjedhjes së vendbanimit në territorin e një shteti; e drejta shtetësisë; e drejta e martesës dhe e zgjedhjes së bashkëshortit/bashkëshortes; e drejta e pronës; e drejta e trashëgimisë; e drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar; e drejta e lirisë së mbledhjes dhe krijimit të organizatave paqësore. Të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore ku përfshihen kryesisht: e drejta e punës; e drejta e krijimit të sindikatave dhe e anëtarësimit në to; e drejta e strehimit; e drejta e trajtimit shëndetësor, sigurimit shoqëror dhe shërbimeve sociale; e drejta e arsimit dhe përgatitjes profesionale etj. (neni 5)

[8] Ligji Nr. 7768, datë 09.11.1993

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (CRC)[9], e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, ka hyrë në fuqi në vitin 1990. Shqipëria e ka ratifikuar këtë Konventë në vitin 1992[10]. Konventa garanton parimin e barazisë dhe përcakton detyrimin e shteteve pale që të ndërmarrin të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinioneve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjor ose të anëtarëve të familjes së tij

Gjithashtu, Konventa përmban edhe 2 Protokolle Opsional, të ratifikuar nga R.Sh. Protokolli Opsional i Konventës së OKB-së "Për Të Drejtat e Fëmijëve", Për Përfshirjen e Fëmijëve në Konflikte të Armatosur[11] dhe Protokolli Opsional i Konventës Së OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijëve", Për Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin dhe Pornografinë me Fëmijë.[12]

I.1.2. Instrumentet në kuadrin e Këshillit të Evropës

Sipas standardeve të Këshillit të Evropës, legjislacioni për trajtimin e barabartë duhet të ndalojë diskriminimin, ngacmimin dhe viktimizimin për shkaqe të tilla, si gjinia ose seksi, origjina racore ose etnike, aftësitë e kufizuara, orientimi seksual, mosha dhe feja ose besimi, midis të tjerash, të ofrojë të drejta të zbatueshme në këto fusha, dhe të krijojë struktura kombëtare për promovimin e barazisë. Të njëjtat standarde identifikojnë që fusha e legjislacionit të trajtimit të barabartë mbulon më së shumti punësimin, trajnimin dhe formimin profesional, por mund të përfshijë gjithashtu edhe fusha jashtë punës, si aksesi në mallra dhe shërbime, strehimi, arsimi, mbrojtja sociale, kujdesi shëndetësor ose përparësi të tjera sociale.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore[13] është nënshkruar në Romë me 4 nëntor 1950 dhe hyri në fuqi me 3 shtator të vitit 1953. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në vitin 1996.[14]

Standardet e Këshillit të Evropës bazohen në nenin 14 të KEDNJ, "ndalimi i diskriminimit", në përmbajtjen e të cilit parashikohet se: "*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër*". Siç mund të konstatohet, në këtë nen mbrojtja nga diskriminimi gjen zbatim në lidhje me ato të drejta dhe liri themelore të parashikuara në Konventë dhe në Protokollet e saj shtesë.

---

[9] Convention on the Rights of the Child
[10] Ligj datë 27.02.1992
[11] Ratifikuar me Ligj Nr.9833, datë 22.11.2007
[12] Ratifikuar me Ligj Nr.9834, datë 22.11.2007
[13] KEDNj u nënshkrua në nëntor 1950 dhe hyri në fuqi në shtator 1953 pas ratifikimit të dhjetë të saj nga Dukati i Luksemburgut
[14] Ligji Nr. 8137, datë 31.07.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", i ndryshuar.

Protokolli 12 (2000) i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, i cili është ratifikuar nga Shqipëria në nëntor 2004 dhe ka hyrë në fuqi me 5 prill 2005i, e zgjeron fushën e ndalimit të diskriminimit duke garantuar trajtim të barabartë lidhur me gëzimin e çdo të drejte të parashikuar me ligj (përfshirë të drejtat sipas legjislacionit kombëtar). Në nenin 1 "*ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit"*, sanksionohet në mënyrë të shprehur se "*Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër*" dhe se "*Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1*".

Karta Sociale Evropiane e rishikuar,[15] e nënshkruar më 1998 dhe e ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh-së në vitin 2002, sanksionon parimin e barazisë dhe parimin e mosdiskriminimit. Karta Sociale Evropiane e vitit 1961/1965 përbën një traktat kryesor evropian dhe plotëson Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale. Karta Sociale Evropiane e rishikuar, e nënshkruar në vitin 1998 dhe e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 2002, po zëvendëson gradualisht Kartën Sociale Evropiane.

Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 1999[16], ka qëllim themelor sigurimin e zbatimit të parimeve të barazisë dhe mos-diskriminimit për personat që i përkasin pakicave kombëtare. Kjo konventë ndalon çdo diskriminim bazuar në përkatësinë në një pakicë kombëtare, duke përcaktuar detyrimin e shteteve nënshkruese të kësaj Konvente për t'u garantuar personave që i përkasin pakicave, të drejtën e barazisë para ligjit dhe mbrojtjen e barabartë nga ligji.

Konventa Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje[17] është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2012. Qëllimi i kësaj konvente është të angazhojë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet e tjera nënshkruese për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga të gjitha format e dhunës dhe parandalimin, ndjekjen penale dhe eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; duke kontribuar ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimit të barazisë thelbësore midis burrave dhe grave; ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës për organizatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit për të bashkëpunuar në mënyrë efektive, me qëllim miratimin e një përqasjeje të integruar për të eliminuar dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.

Konventa garanton të drejtat themelore, barazinë dhe mosdiskriminimin e grave nëpërmjet parashikimit të masave për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër.

---

[15] Ligji Nr. 8960, datë 24.10.2002
[16] Ligji Nr. 8496, date 03.06.1999
[17] Ligj Nr. 104 date 11.08.2012 'Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje"

I.1.3. Standardet e Bashkimit Evropian

Standardet më gjithëpërfshirëse në lidhje me mosdiskriminimin janë zhvilluar në nivelin e Bashkimit Evropian. Ato përbëhen nga një sërë burimesh të ndryshme ligjore që përcaktojnë format e ndryshme të diskriminimit dhe i detyrojnë shtetet anëtare t'i zbatojnë këto standarde në kornizën e tyre legjislative, si dhe në praktikën gjyqësore. Këto njohje kanë çuar në zhvillimin e disa standardeve legjislative për mbrojtjen nga diskriminimi, me vëmendje të veçantë tek ata persona dhe grupe që konsiderohen të jenë më të prekshëm sesa të tjerët.

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta) i dedikon një kre/titull të tërë "barazisë". Neni 20 parashikon barazinë përpara ligjit dhe Neni 21 i saj kërkon *ndalimin e çdo diskriminimi për çdo shkak, të tillë si gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, karakteristikat gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinioni politik apo ndonjë mendim tjetër, anëtarësia e një pakice kombëtare, pasuria, lindja, mosha ose orientimi seksual*.

Të drejtat dhe parimet e sanksionuara në Kartë duhet të zbatohen në praktikën ligjore kombëtare në rastet kur:

- Legjislacioni që zbaton të drejtën e BE-së ka rëndësi (si instrument interpretimi).
- Legjislacioni kombëtar konsiderohet se ndërhyn me të drejtën e BE-së.
- Autoritetet e BE-së kanë vepruar në zbatim të së drejtës së BE-së.

Neni 19 i **Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU)** i ka mundësuar Bashkimit Evropian … të marrë veprimet e duhura për të luftuar diskriminimin *në bazë të gjinisë, origjinës racore ose etnike, fesë ose besimit, aftësisë së kufizuar, moshës, ose orientimit seksual*. Kjo kompetencë ka çuar në miratimin e:

- Direktivës 2000/43/KE "*Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht prejardhjes racore apo etnike*"; (Direktiva për racën)
- Direktivës 2000/78/KE "Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe në marrëdhëniet gjatë punës"; (Direktivën për barazinë në punësim)
- Direktivave 2004/113/KE "*Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime"*; 2006/54/KE "*Për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës*" 2010/41/BE (Direktivat për barazinë gjinore).

Direktivat për Trajtim të Barabartë e Bashkimit Evropian përcaktojnë standardet minimale në legjislacionin për trajtimin e barabartë. Ato ndalojnë diskriminimin, ngacmimet dhe ngacmimet seksuale, viktimizimin në punësim dhe profesion për shkak të përkatësisë gjinore, origjinës racore ose etnike, orientimit seksual, fesë ose besimit dhe aftësisë së kufizuar; dhe në sigurimin e mallrave dhe shërbimeve për shkak të përkatësisë gjinore dhe origjinës racore ose etnike.

Direktiva për Racën ndalon diskriminimin në bazë të përkatësisë racore ose etnike në fushën e punësimit, arsimit, aksesit dhe furnizimit me mallra dhe shërbimeve që janë në dispozicion të

publikut, duke përfshirë strehimin, mbrojtjen sociale, përfshirë sigurimin social dhe kujdesin shëndetësor, avantazhet sociale, etj.

Direktiva për Barazinë në Punësim ndalon diskriminimin në bazë të fesë dhe besimit, orientimit seksual, moshës, aftësisë së kufizuar në fushën e punësimit.

Direktivat për Barazinë Gjinore synojnë eliminimin e diskriminimit në fushën e punës, duke përfshirë vetëpunësimin dhe aksesin në mallra dhe shërbime në bazë të gjinisë. Praktika gjyqësore e GJED-së tregon se këtu përfshihet edhe **identiteti gjinor**.

I.2. Kuadri Ligjor Shqiptar

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon, në pjesën e dytë të saj, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si vlera që qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik shqiptar. Këto të drejta dhe liri janë të ndara në: liri dhe të drejta vetjake; liri dhe të drejta politike; si dhe liri dhe të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore. Në nenin 18/1 të Kushtetutës është parashikuar parimi i barazisë në të cilin sanksionohet se "*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit*" dhe në nenin 18/2 parimi i mosdiskriminimit, në përmbajtjen e të cilit sanksionohet se "*Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore*" dhe se "*Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive*".

Në vitin 2016, Kuvendi ka miratuar me unanimitet amendimet kushtetuese në kuadër të reformës në drejtësi, një nga të cilët paraqet ndryshim në kompetencat e KMD. Konkretisht, është amendimi Kushtetutës i cili sanksionon të drejtën e KMD për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, përmes ligjit nr. 76/2016, *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë",* të ndryshuar, duke sanksionuar, ne nenin 134, se "*Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: ... (e) çdo komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta".*

Ligji nr. 10 221 datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*" i cili pas dekretimit nga Presidenti i Republikës dhe botimit në Fletoren Zyrtare, hyri në fuqi më datë 13 Mars 2010. Ky ligj erdhi me propozim të një grupi deputetësh dhe është një hap konkret në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nën frymën e dokumenteve ndërkombëtarë dhe njëkohësisht, një hap konkret i përmbushjes së standardeve të anëtarësimit në BE.

Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi" është në përputhje të plotë me Direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e barazisë dhe konkretisht është përafruar plotësisht me: Direktivën 2000/43/KE për "*Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike*", Direktivën 2000/78/KE për "*Përcaktimin e një kuadri të*

përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës", Direktivën 2004/113/KE për "*Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime*" dhe Direktivën 2006/54/KE për "*Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës*".

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo-shteruese të shkaqeve te mbrojtura te diskriminimit, duke iu referuar shprehimisht gjinisë, racës, ngjyrës, përkatësisë etnike, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore apo sociale, shtatzënisë, prindërve, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit civil, banimit, gjendjes shëndetësore, predispozitave gjenetike, paaftësisë, përkatësisë në një grup të caktuar - ose çdo shkak tjetër (neni 1). Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë e individit si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi. Fushat kryesore në të cilat sigurohet kjo mbrojtje ligjore përfshijnë mbrojtjen nga diskriminimi në punësim si dhe gjatë periudhës së ushtrimit të marrëdhënieve të punës, në fushën e arsimit si dhe në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve.

Me qëllim zbatimin efektiv të këtij ligji, është themeluar institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si i vetmi autoritet përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Komisioneri shtrin kompetencat jo vetëm në sektorin publik, por edhe në sektorin privat.

Në nenin 39, ligji ka parashikuar detyrimin e Këshillit të Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 18 të këtij ligji. Ligji 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*" ka 9 vite nga miratimi dhe hyrja në fuqi e tij dhe këto akte nënligjore nuk janë nxjerrë ende.

Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë[18], ndalon çdo formë diskriminimi, të parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion. Neni 9/2, përkufizon diskriminimin si *çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët*[19].

Përshtatja e arsyeshme e vendit të punës për personat me aftësi të kufizuar ose persona të ndodhur në kushte të tjera, të përmendura në pikën 2, të këtij neni është përcaktuar si detyrim për punëdhënësin. Mohimi i përshtatjes së arsyeshme përbën diskriminim.

[18] Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, ndryshuar në vitin 2015.
[19] Ndryshuar me ligjin Nr. 136/2015, datë 5.12.2015.

Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me: a) mundësinë për punësim, vetëpunësim dhe profesion, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit, të çfarëdo lloj dege të aktivitetit dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, si dhe ngritjen në detyrë; b) qasjen në të gjitha llojet dhe në të gjitha nivelet e orientimit profesional, trajnimit profesional, trajnimit dhe ritrajnimit të avancuar profesional, përfshirë edhe përvojën e punës në praktikë; c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën; ç) anëtarësimin dhe aktivizimin në organizata sindikale dhe organizata të punëdhënësve, ose ndonjë organizatë, anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, duke përfshirë përfitimet e siguruara nga këto organizata.

Ndryshimet e rëndësishme të vitit 2015, referojnë në ndjekjen e procedurave të ankimit, të përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, kur një person pretendon se është cenuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion dhe në të gjitha procedurat e ankimit lidhur me sa më lart, zbatohet parimi i zhvendosjes së barrës së provës.

Në Kodin e Punës, parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit parashikohet edhe në dispozita të tjera si: Ndalimi i përdorimi të punës së detyruar si masë diskriminimi racial, shoqëror, kombëtar ose fetar (neni 8, prg. 2, germa (e); Barazia në shpërblim (neni 115); Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme (neni 146) ku konkretisht parashikohet se: "*1. Zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi, konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme kur: c) shkel ndalimin e diskriminimit, sipas përcaktimeve në këtë Kod dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi*"; Ndalimi i diskriminimit ndaj përfaqësuesve të sindikatës (neni 181/3) dhe mos dhënia e pëlqimit nga përfaqësuesit e organizatës sindikale për zgjidhjen e kontratës, nëse zgjidhja e kontratës shkel parimin e trajtimit të barabartë (neni 181/4); Ndalimi i diskriminimit për shkak të pjesëmarrjes ose jo në grevë (neni 197/4); Trajtimi i barabartë (neni 149/2) lidhur me përfundimin e kontratave me afat të caktuar, ku përcaktohet shprehimisht se "*Punëmarrësit e punësuar me kontratë me afat të caktuar nuk mund të trajtohen në mënyrë më pak të favorshme se punëmarrësit e punësuar me kontratë me afat të pacaktuar, lidhur me kushtet e punësimit, trajnimit dhe mundësive të karrierës në punë. Punëmarrësit me kontratë pune me afat të caktuar gëzojnë të njëjtat të drejta, përpjesëtimisht, si punëmarrësit me kontratë me afat të pacaktuar."* etj.

Kodi Penal[20] ka pësuar ndryshime të rëndësishme në vitin 2013 lidhur me mbrojtjen e komunitetit LGBTI. Konkretisht, Parlamenti shqiptar miratoi, si rrethanë rënduese për dënimin e një krimi, përfshirjen e orientimit seksual si shkak të ri, kur vepra penale është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë, ndër të tjera, me këtë shkak, (neni 50/j). Konkretisht, është parashikuar se "*Rëndojnë dënimin rrethanat që vijojnë: j) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar.*".

[20] Ndryshuar nga Ligji Nr. 144/2013; ndryshuar në vitin 2017.

Shkelja e barazisë së shtetasve (neni 253) parashikon dënimin e kryerjes për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, orientimi seksual ose identiteti gjinor, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji. Me amendimet e vitit 2013, u shtua orientimi seksual dhe identiteti gjinor.[21]

Dispozita në lidhje me nxitjen e urrejtjes ose grindjeve (neni 265) u ndryshua gjithashtu në vitin 2013 duke shtuar orientimin seksual si shkak të mbrojtur nga diskriminimi, si dhe duke zgjeruar fushëveprimin e tij me aktin e përhapjes dhe shpërndarjes së çdo përmbajtjeje që nxit urrejtje ose grindje. Sipas kësaj dispozite, "*Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet".*

Kodi i Familjes[22]. Statusi ligjor i një çifti lidhet me një sërë implikimesh ligjore në fusha të ndryshme të jetës. Në Shqipëri, martesa është ende e kufizuar tek një burrë dhe një grua të moshës 18 vjeç e sipër. Martesat e të njëjtit seks nuk janë ende të pranuara. Megjithatë, në jetën e përditshme, të drejtat që rrjedhin nga bashkëjetesa janë të rëndësishme për dhënien me qira të një banese, për kontratat e sigurimit, për përfitimet sociale etj. Megjithatë, bashkëjetesa në Kodin e Familjes që është në fuqi në Shqipëri, përkufizohet si një bashkim faktik midis një burri dhe një gruaje që jetojnë si çift, të cilët jetojnë përbashkërisht në një jetë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme.

Kodi i Procedurës Administrative[23] *parashikon si një nga parimet e përgjithshme parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit (neni 17), sipas të cilit "1.Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë" dhe "3. Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër".*

Lidhur me mjetet e kërkimit të provës në kuadër të hetimit administrativ, Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit (neni 82, paragrafi 2). Konkretisht, ky Kod ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës për çështjet e diskriminimit, duke sanksionuar shprehimisht se: "*Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet*

[21] Në këtë dispozitë janë shtuar fjalë, me ligjin Nr. 144/2013, datë 2.5.2013.
[22] Kodi i Familjes i Shqipërisë, Ligji Nr. 9062, miratuar në maj, 2003.
[23] Miratuar me Ligjin Nr. 44/2015, Fletore Zyrtare 87/2015

të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.".

Kodi i Procedurës Civile

Ndryshimet e fundit që i janë bërë Ligjit Nr. 8116, datë 29.03.1996 *"Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë",* të ndryshuar, të miratuara përmes Ligjit nr. 38/2017, datë 30.3.2017 dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 98, datë 5 maj 2017, kanë hyrë në fuqi në nëntor 2017.

KMD konstaton se edhe me këto ndryshime, nuk është ndërmarrë ndonjë nismë për të ndryshuar barrën provës gjatë procesit civil, në rastet kur gjykata shqyrton një çështje diskriminimi, një kërkesë kjo e direktivave të Bashkimit Evropian në fushën e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Në përputhje me to, ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *"Për mbrojtjen nga diskriminimi"*, në Kreun VI "Procedurat përpara gjykatës", ka parashikuar zhvendosjen/shpërndarjen e barrës së provës në rastet kur gjykata shqyrton një çështje diskriminimi, ndryshe nga parimi i përgjithshëm për barrën e provës, sipas të cilit detyrimi për të vërtetuar faktet e nevojshme për të provuar pretendimin është i palës që e pohon atë.

Bazuar në këto standarte, KMD në mënyrë të përsëritur ka dërguar rekomandime për zhvendosjen e barrës së provës në procesin civil, kur një çështje ka të bëjë me pretendim diskriminimi, të cilat nuk janë marrë parasysh.

Parimi i barrës së provës parashikohet nga Kodi i Procedurës Civile në nenin 12, ku thuhet: "Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj".

Pra, nëse normalisht detyrimin për të provuar pretendimet duhet t'a kishte paditësi, sipas legjislacionit të BE-së në çështjet e diskriminimit, në momentin që paditësi vërteton rastin *prima facie* -"*në pamje të parë*"[24], atëherë i kërkohet të paditurit, që të paraqesë prova se ai/ajo nuk e ka diskriminuar paditësin, duke rrëzuar prezumimin faktik se ka patur diskriminim.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, e shtrin zbatimin e tij si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Me Ligjin "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", Kodin e Procedurave Administrative (Kodi i ri), dhe ndryshimet e fundit në Kodin e Punës, është harmonizuar dhe rregulluar shpërndarja e barrës së provës lidhur me çështjet e diskriminimit në sektorin publik. Me qëllim rregullimin dhe harmonizimin e zhvendosjes së barrës së provës për çështjet e diskriminimit edhe në sektorin privat, është e nevojshme që një parashikim i tillë të shtohet edhe në Kodin e Procedurës Civile.

Kodi i Procedurës Civile është ligji bazë për procedurat që gjykatat duhet të respektojnë gjatë veprimtarisë së tyre, duke e bërë këtë Kod me rëndësi nga këndvështrimi i garantimit të mbrojtjes efektive nga diskriminimi. Kodi i Procedurës Civile, duke qenë në një nivel më të lartë në hierarkinë e normave, se sa ligjet e miratuara me shumicë të thjeshtë, përfshirë këtu ligjin 10221/2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", e bën problematike zbatimin e këtij standarti. Kështu, gjykatat gjenden midis kërkesave të ligjit "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", i cili ka

[24] Paditësi sjell fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka ndodhur diskriminimi në mungesë të një shpjegimi të përshtatshme.

parashikuar zhvendosjen e barrës së provës, në përputhje me legjislacionin e BE, dhe Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon rregullin e përgjithshëm, sipas të cilit, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë pretendimin e saj.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar me Ligjin nr. 37/2017, datë 30 mars 2017, ka hyrë në fuqi me 1 janar 2018. Ky Kod përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale. Ky Kod përmban rregullime edhe për të rinjtë nga grupmosha 18 deri në 21 vjeç, sipas parashikimeve në nene të veçanta (neni 1).

Në Kreun II të Kodit parashikohen Parime të Drejtësisë Penale për të Mitur, ku, ndër të tjerë, sanksionohet "Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi", neni 11, i cili parashikon shprehimisht se "*1. Të drejtat që burojnë nga ky Kod i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzania, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje tjetër e të miturit, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit*", dhe "*2. Të drejtat për të miturin, të parashikuara në këtë Kod, mbrohen nga të gjitha format e diskriminimit për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni*". Kështu, mbrojtja nga diskriminimi i çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit, garantohet për të gjitha shkaqet e diskriminimit të listuara me ligj por jo shteruese, ç'ka është në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 1 të ligjit 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*". Gjithashtu, kjo mbrojtje garantohet për të gjitha format e diskriminimit, citohet në Kod, duke referuar në parashikimet e nenit 3 të Ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", ku parashikohen ato, sipas përkufizimeve përkatëse.

Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"

Ligji Nr. 18/2017 "*Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve*", është miratuar në shkurt të vitit 2017 dhe ka hyrë në fuqi tre muaj pas miratimit, pra në qershor të vitit 2017.

Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës (neni 1).

Bazuar në këtë ligj, realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke zbatuar këto parime: 1. Fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive. 2. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën. ***3. Barazia dhe mosdiskriminimi.*** 4. Përgjegjësia parësore e prindit dhe kujdestarit për t'i krijuar kushtet e jetesës, për t'i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin fëmijës. 5. Ndarja e përgjegjësive

ndërmjet prindit ose kujdestarit të tij, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë për mbrojtjen e fëmijës. 6. Çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe ndarja e fëmijës nga familja duhet parë si zgjidhja e fundit. 7. Decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijës, ndërhyrja ndërsektoriale 4 dhe partneriteti ndërmjet institucioneve publike e jopublike, të autorizuara me ligj. 8. Ofrimi i shërbimit të personalizuar e të specializuar për çdo fëmijë. 9. Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës. 10. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. 11. Garantimi i stabilitetit e vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimin e fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor. (neni 5, "parime të përgjithshme").

Me këtë ligj, një rregullim i veçantë parashikohet për fëmijët me aftësi të kufizuar (neni 32) dhe atyre që i përkasin pakicave kombëtare (neni 33).

Ligj Nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri"

Ky ligj rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore. (neni 1)

Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë dhe të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo forme me të cilën shfaqet. (neni 2)

Ndër të tjera, ky ligj bazohet edhe në parimin e barazisë e të mosdiskriminimit.

Ndalimi i diskriminimit për shkak të gjinisë parashikohet në nenin 6 të këtij ligji, sipas të cilit "1. Çdo trajtim më pak i favorshëm i një personi për shkak të gjinisë, në krahasim me trajtimin që i bëhet, i është bërë ose do t'i bëhej një personi të gjinisë tjetër, në një situatë të ngjashme, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë dhe ndalohet".

Gjithashtu, ky ligj parashikon në pjesë të veçanta, mbrojtjen dhe trajtimin e barabartë, në bazë të përkatësisë gjinore , në marrëdhëniet e punës; në arsim dhe kualifikim; dhe në media.

Organet përgjegjëse për mbarëvajtjen e barazisë gjinore, të parashikuar me këtë ligj bashkë me detyrat përkatëse janë: Këshilli i Ministrave; Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore; Autoriteti shtetëror përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe të programeve shtetërore për barazinë gjinore (ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore); dhe organet e qeverisjes vendore.

Ligj "Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë"

Ligji Nr. 96/2017 "*Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë*", është miratuar me datë 13.10.2017 dhe ka hyrë në fuqi në nëntor 2017. Sipas objektit të tij, të parashikuar në nenin 1, ky ligj rregullon ushtrimin e të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parimet e parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, ratifikuar me ligjin nr. 8496, datë 3.6.1999, dhe marrëveshjet

ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, ku Republika e Shqipërisë është palë. Ky ligj ka për qëllim të sigurojë ushtrimin e të drejtave specifike të personave që u përkasin një pakice kombëtare, të cilat janë të nevojshme për mbrojtjen e identitetit dallues të pakicave kombëtare, si një përbërës thelbësor i një shoqërie të integruar dhe që garantojnë mosdiskriminimin dhe barazinë e plotë para ligjit. (neni 2, pika 1).

Në nenin 8, thuhet se: "1. Ndalohet çdo diskriminim ndaj cilido personi për shkak të përkatësisë së tij/së saj në një pakicë kombëtare. 2. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, miratojnë dhe zbatojnë masat e nevojshme: a) për të garantuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës; b) për të mbrojtur personat që u përkasin pakicave kombëtare nga kërcënimet, diskriminimi, armiqësia apo dhuna për shkak të identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional; c) për të forcuar dialogun ndërkulturor; ç) për të nxitur respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, pa dallim për sa i përket identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional. 3. Masat e miratuara në përputhje me pikën 2, të këtij neni, nuk përbëjnë akte diskriminimi".

Ky ligj parashikon gjithashtu njohjen e pakicave kombëtare, sipas një procedure të caktuar dhe liston të drejtat dhe liritë e pakicave kombëtare në R.Sh. Bazuar në këtë ligj, është ngritur Komiteti për Pakicat Kombëtare, si një institucion qendror në varësi të Kryeministrit, me qëllim sigurimin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe të interesave të pakicave kombëtare, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

Ligj "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"

Ligji i ri për ndihmën juridike Nr. 111/2017 *"Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"* përcakton format, kushtet, procedurën dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të individit dhe të interesave të ligjshëm të tij.

Parimet e ndihmës juridike, sipas nenit 4 të këtij ligji, përcaktojnë se, dhënia e ndihmës juridike bazohet, ndër të tjera, në parime si: akses i barabartë i individëve në ndihmën juridike; barazi dhe mosdiskriminim i individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike si dhe në mbrojtjen e të drejtave të personave vulnerabël.

Ky ligj, ka parashikuar, në nenin 11, kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike, sipas të cilit: Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre: a) viktimave të dhunës në familje; b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal; c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal; ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesit shoqëror; d) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor; dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit; e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit

të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor; ë) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore; f) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi; g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor; gj) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale; h) personave, të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligj "Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara"

Ligji Nr. 93/2014 "*Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara*", ka për qëllim të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes.

Në këtë ligj jepen përkufizime të termave si ""Diskriminim i personave me aftësi të kufizuara", "Mohim i përshtatjes së arsyeshme" apo edhe "Përshtatje e arsyeshme" të cilat janë në përputhje me përkufizimet e Ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".

Në nenin 4 përcaktohet shprehimisht se, parimet bazë të këtij ligji, janë, ndër të tjera: a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë; b) barazia, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta.

Në nenin 16, "monitorimi", paragrafi 2, parashikon se: "Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të parashtruara në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Ligji 44/2012 "Për shëndetin mendor"

Ligji Nr. 44/2012 "*Për shëndetin mendor*", sipas objektit të tij në nenin 2, përcakton procedurën dhe kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor, nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, sigurimit të një mjedisi social të përshtatshëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor dhe nëpërmjet politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.

Në nenin 3 jepen përkufizimet, ku termi "diskriminim" përkufizohet në përputhje me ligjin 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*".

Ndër parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor parashikohet, sipas nenit 5/1, germa (a), trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime të shëndetit mendor, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor.

Neni 8 parashikon mbrojtjen nga diskriminimi, sipas të cilit "Personave me çrregullime të shëndetit mendor u sigurohet mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, në këtë fushë".

Ky ligj është në përgjithësi në përputhje me nenin 25 dhe nene të tjera të KPDAK përsa i përket shërbimeve që parashikon për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Përjashtim bën neni 9 që parashikon heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar dhe nenet 21-25 mbi trajtimin e pavullnetshëm, të cilat nuk janë në përputhje me KPDAK.

Ligji Nr. 7889/1994 "Për statusin e invalidit të punës", i ndryshuar

Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994 "*Për statusin e invalidit të punës*", i ndryshuar, parashikon se Shoqëria dhe shteti marrin ne mbrojtje invalidët, ne mënyrë qe ata te marrin pjese ne jetën shoqërore njëlloj si te tjerët, t'u sigurohet niveli ekonomik i nevojshëm për te jetuar ne mënyrë dinjitoz, te kenë kushte banimi, te shfrytëzojnë mjedisin e jashtëm, te kenë një pune te përshtatshme, si dhe t'u krijohen mundësi normale për kurim, arsimim dhe veprimtari çlodhëse e argëtuese (neni 2).

Ky ligj parashikon disa lehtësi për individët që gëzojnë statusin e invalidit të punës, si: pajisjen me a) mjete lëvizëse përfshi edhe autovetura dhe pajisje te ndryshme ortopedike. b) me mjete ndihmëse dëgjimore e pamore speciale; c) me mjete ndihmëse kardiake etj; - Për të paralizuarit dhe të gjymtuarit rëndë që nuk lëvizin, organizohet shërbimi mjekësor në banesë falas; Udhëtimi i invalidëve me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat qytetas bëhet falas ndërsa udhëtimi me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat ndërqytetas bëhet me 50 përqind të vlerës se biletës; Invalidët favorizohen në ndjekjen e kurseve të kualifikimit e të rikualifikimit profesional, si dhe ndjekjen e shkollave të larta.

Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbrit", i ndryshuar

Bazuar në nenin 1, përfitojnë nga ky ligj të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshëm shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët sipas kritereve mjekësore janë të paaftë për punë në kushte normale.

Shteti mbron të verbërit nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes. Kur këto përbëjnë vepër penale, iniciativën për fillimin e çështjes penale, përveç kujdestarit e ka edhe organi i prokurorisë apo organizata, në të cilën ata bëjnë pjesë ose përkujdeset për ta (neni3).

Ligji Nr. 8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", i ndryshuar

Nga ky ligj përfitojnë të gjithë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga mosha, koha, vendndodhja e aksidentit dhe çasti i sigurimit. (neni 1). Shteti krijon kushte për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëlloj si të tjerët, duke siguruar për ta një nivel ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimtari çlodhëse, argëtuese dhe sportive (neni 3). Shteti mbron të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga të gjithë llojet e shfrytëzimit, të diskriminimit, të abuzimit dhe të fyerjes (neni 4).

Edhe ky ligj parashikon disa lehtësi dhe përfitime për personat që gëzojnë këtë status.

Ligji "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar

Ligji Nr. 44/2016 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore",* të ndryshuar, në përputhje edhe me standartet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPAK), si dhe ligjit nr. 93/2014 "*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK*", ka integruar konceptet e *"Vlerësimit bio-psiko-social"* dhe *"Komisionit shumëdisiplinor për vlerësimin e aftësisë së kufizuar".*

Ligji ka shtuar si përfitues të shërbimeve shoqërore azilkërkuesit e mitur, të pashoqëruar.

Ligji nr. 44/2016, ka përcaktuar se përfituesve të klasifikuar me vendim të KMCAP-it në grupet e aftësisë së kufizuar, u ndërpritet pagesa pas 48 muajve punësimi, duke i mbajtur në skemë personat edhe për 24 muaj të tjerë, ndryshe nga parashikimi i mëparshëm ligjor i futur me ligjin nr. 47/2014, *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"*, të ndryshuar, i cili parashikonte se *"Përfituesve, të klasifikuar me vendim të KMCAP-it në grupet e aftësisë së kufizuar, u ndërpritet pagesa pas 24 muajsh punësimi".*

Gjithashtu, ligji nr. 44/2016 ka parashikuar të drejtën e ankimit edhe në gjykatë. Ligji përcakton se, aplikuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuar, që pretendojnë se u është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzojnë të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.".*

Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"

Ky ligj ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. (neni 1).

Ligji përcakton llojet e përfitimeve dhe lehtësive, individët dhe grupet e individëve që përmbushin kushtet për të përfituar, si dhe procedurat e kërkimit e të përfitimit të të drejtave të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe rolin dhe përgjegjësitë e organeve publike dhe jopublike të ngarkuara me zbatimin e tij.(neni 2)

Ligji jep një përkufizim të diskriminimit, që është në përputhje dhe harmoni me ligjin "*Për mbrojtjen nga diskriminimi"* (neni 3, pika 19).

Gjithashtu, ligji parashikon se, shërbimet shoqërore administrohen në bazë të parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore, ku ndër të tjera, edhe parimin e mosdiskriminimit. Sipas kësaj të fundit, në nenin 4 pika (ë) përcaktohet se, ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligj nr. 22/2018 "Për strehimin social"

Ky ligj është miratuar rishtazi në Maj 2018 dhe ka hyrë në fuqi në muajin nëntor 2018. Objekti dhe qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat

e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Në nenin 10, ligji ka parashikuar parimin e mosdiskriminimit, si një ndër parimet e politikave të strehimit, duke theksuar shprehimisht se: "1. Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individi, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja diskriminuese. 2. Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të përfituar strehim në një nga programet sociale të strehimit për shkaqe të përmendura në pikën 1, të këtij neni, përveç rasteve kur një program social strehimi është i programuar në mënyrë të posaçme dhe të shprehur për t'i ardhur në ndihmë individëve ose grupeve në nevojë."

Ligj nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"

Qëllimi i këtij ligji është, nga njëra anë, parandalimi dhe goditja e korrupsionit, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat dhe nga ana tjetër, mbrojtja e individëve që sinjalizojnë veprimet ose praktikat e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës.

Edhe pse qëllimi i këtij ligji në vetvete ka të bëjë me parandalimin dhe goditjen e korrupsionit, nga veprimtaria e deritanishme e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka rezultuar se individët të cilët denoncojnë apo sinjalizojnë veprime korruptive të ndodhura në vendin e tyre të punë, janë përballur me situata diskriminuese. Për këtë arsye, vlerësojmë se rregullimi dhe mbrojtja me ligj e personave që sinjalizojnë veprime apo praktika të dyshuara korruptive, përbën një zhvillim pozitiv edhe në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi.

Ligj nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"

Ligji "*Për arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë*" i miratuar në vitin 2012 ka parashikuar si shkaqe të diskriminimit edhe "orientimin seksual". Neni 5/1 ndonëse nuk i përfshin të gjitha shkaqet e parashikuara në Nenin 1 të Ligjit "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*" ka lënë hapësira të mjaftueshme për zbatimin e këtij të fundit nga sistemi arsimor para-universitar[25].

Në nenin 5, ku parashikohet e drejta për arsimim, thuhet shprehimisht se "1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar."

[25] KMD, Raport i Veçantë "*Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri*", fq.13.

Ligji parashikon edhe parimet e përgjithshme, ku në Nenin 6/3, thuhet se: "Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t'u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral".

Ligj nr. 8328, datë 16.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar

Ligji *nr. 8328, datë 16.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*", i ndryshuar, parashikon respektimin e të drejtave të njeriut, në nenin 5, ku të paraburgosurit dhe të dënuarit trajtohen me dinjitet, pa njëanshmëri dhe pa diskriminim dhe duke respektuar të drejtat njerëzore të tyre, të grave të paraburgosura dhe të dënuara, të të miturve të paraburgosur, të paraburgosurve dhe të dënuarve me çrregullime të shëndetit mendor dhe të paraburgosurve dhe të dënuarve me aftësi të kufizuar.

Këto ndryshime kërkojnë parandalimin e çdo akti dhune me bazë gjinore që sjell dëmtim fizik, seksual ose psikologjik, vuajtje ose çdo formë tjetër abuzimi e keqtrajtimi ndaj grave të paraburgosura dhe të dënuara.

Në përputhje me legjislacionin për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin, ky ligj parashikon se, masat e veçanta, që janë të nevojshme të zbatohen për grupe të veçanta të të paraburgosurve dhe të dënuarve nuk konsiderohen diskriminim.

Masa mbrojtjeje, mbështetjeje dhe këshillime ligjore, me qëllim rehabilitimin u ofrohen të paraburgosurve dhe të dënuarve që kanë pasur përvoja të përballjes me forma të ndryshme dhune, para ose gjatë qëndrimit në institucion.

Me këto ndryshime ligjore, trajtimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve orientohet nga rehabilitimi dhe ri-integrimi i individualizuar sipas nevojave. Programe kulturore të veçanta parashikohen të ofrohen për të paraburgosurit dhe të dënuarit që i përkasin minoriteteve etnike dhe gjuhësore, të huajve dhe personave pa shtetësi.

Edhe shërbimi shëndetësor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale organizohet pa diskriminim, për shkak të statusit ligjor të personit në institucion ose për çdo shkak tjetër.

Ligji "Për mediat audiovizive në Shqipëri"

Ligji 97/2013, në nenin 32 parashikon që shërbimet e mediave audio dhe/ose audiovizive nuk duhet të transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi. Gjithashtu, neni 42 paragrafi 3/b parashikon se *komunikimet audiovizuale tregtare nuk duhet të kenë përmbajtje që përfshijnë ose promovojnë diskriminim për shkak të gjinisë, origjinës racore ose etnike, kombësisë, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual*.

Gjithashtu, sipas Seksionit 4/10 të kodit të udhëzimeve etike për transmetimet audiovizuale të miratuara nga Bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizuale (AMA), *informacioni i transmetimit nuk duhet të përmbajë përmbajtje diskriminuese në lidhje me shkaqe të tilla si raca, ngjyra, përkatësia etnike, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, mendimet politike, bindjet fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose sociale, ose për ndonjë shkak tjetër*.

I.3. Kuadri Ligjor për Themelimin dhe Funksionimin e KMD

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe struktura organizative e tij

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 10 221, më datë 04.02.2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*" i cili hyri në fuqi më datë 13 Mars 2010, pas Dekretimit nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 6433, datë 24.2.2010 dhe botimit në Fletoren Zyrtare Nr. 15 datë 25 shkurt 2010. Bazuar në këtë ligj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është i vetmi autoritet përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Komisioneri e mbështet punën e tij në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

Emërimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin Nr. 60, datë 5.04.2018 "*Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*"[26], zgjodhi z. Robert Gajda në detyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Kështu, nga data 5 Prill 2018**, z. Robert Gajda** është emëruar në detyrën e Komisionerit për Mbrojten nga Diskriminimi të Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në ligjin "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", mandati i Komisionerit është pesë vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

Zyra e KMD

Bazuar në nenin 22 pika 2 të Ligjit 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", Komisioneri mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Zyra ka personelin dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara me ligj.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin me vendimin Nr. 34, datë 20.05.2010 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi" miratoi strukturën organizative të Zyrës së Komisionerit.

Me ketë strukturë organizative, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka funksionuar me 3 drejtori dhe 1 sektor, nga viti 2010 kur është themeluar si institucion deri ne vitin 2018.

[26] Vendimi i Kuvendit Nr. 60/2018 është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 51, datë 12 Prill 2018.

Me vendimin nr. 88, datë 23.07.2018, të Kuvendit të Shqipërisë, është vendosur ndryshimi i strukturës dhe organikës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në bazë të këtyre ndryshimeve është rritur numri i stafit të Zyrës, nga 23 punonjës që ishin me strukturën e vjetër në 34 punonjës me strukturën e re. Në kuadër të projektit të përbashkët të BE/KiE "Rritja e efektivitetit të sistemit Shqiptar të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe anti-diskriminimit", KMD pilotoi 3 zyra rajonale në qytetet Korçë, Gjirokastër dhe Shkodër. Me strukturën e re, tre zyrat rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në qytetet Korçë, Fier, Shkodër, bëhen zyra të përhershme. Në bazë të strukturës së re, me qëllim forcimin e kapaciteteve monitoruese të KMD, janë parashikuar specialist të posaçëm për monitorim dhe raportim.

Struktura organizative e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Kompetencat e Komisionerit

Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian, 2006/54/KE, në nenin 20 të saj, lidhur me *organet e barazisë*, parashikon detyrimin për vendet anëtare të ngritjes së organeve të posaçme në nivel kombëtar për promovimin, analizën, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë të individëve. Në këtë nen parashikohen, gjithashtu, edhe kompetencat kryesore që duhet të gëzojnë këto organe të barazisë dhe, konkretisht:

- të ofrojnë ndihmë të pavarur për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre në lidhje me diskriminimin;
- të kryejnë sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin;

- të publikojnë raporte dhe të japin rekomandime për çdo çështje që lidhet me diskriminimin.

Kompetencat e KMD-së janë parashikuar në nenin 32 të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Sipas parashikimeve të këtij neni, KMD-ja gëzon një sërë kompetencash që shkojnë përtej parashikimeve të Direktivës 2006/54/KE. Në rast se do të kryenim një studim krahasues midis kompetencave të KMD-së, të parashikuara në nenin 32 të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" dhe kompetencave të parashikuara në nenin 20 të Direktivës 2006/54/KE, do të arrinim në këtë klasifikim:

Kompetenca të KMD-së, të parashikuara në ligjin përkatës dhe që kanë për qëllim ofrimin e ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim, përshijnë:

- shqyrtimin e ankesave nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;
- shqyrtimin e ankesave nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi;
- kryerjen e hetimeve administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;
- vendosjen e sanksioneve administrative sipas përcaktimit të këtij ligji;
- parashtrimin e mendimit me shkrim për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin e investuar në saje të kërkesës së gjykatës që shqyrton çështjen;
- përfaqësimin e ankuesit në organet gjyqësore në çështjet civile me miratimin e tij në përputhje me pikën 3 të nenit 34 të këtij ligji.

Kompetenca të KMD-së të parashikuara në nenin 32 të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" dhe që kanë për qëllim kryerjen e sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin, përfshijnë:

- kryerjen e sondazheve në lidhje me diskriminimin;
- monitorimin e zbatimit të këtij ligji.

Kompetenca të KMD-së që kanë për qëllim publikimin e raporteve dhe dhënien e rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin, përfshijnë:

- adresimin e rekomandimeve autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;
- publikimin e raporteve dhe përgatitjen e rekomandimeve për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- kontribuimin në raportimet dhe, sipas rastit, prezantimin e raporteve para organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë.

Kompetenca të KMD-së, të parashikuara në ligjin e mësipërm dhe që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit, përfshijnë:

- nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuar;
- adresimin drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- informimin për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje;
- zhvillimin e dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe
- zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

KAPITULLI II

VEPRIMTARIA E ZYRËS SË KMD PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI DHE PROMOVIMIN E BARAZISË

I. Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim

Bazuar në Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" (LMD), asistenca ndaj viktimave të diskriminimit realizohet përmes:

1. Shqyrtimit të çështjeve nga KMD;
2. Përfaqësimi i çështjeve të diskriminimit në gjykatë.

II.1. Shqyrtimi i çështjeve nga KMD

Bazuar në Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kompetencë:

- të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar,
- të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi,
- të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji,
- t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues,
- të vendosë sanksione administrative sipas përcaktimit të këtij ligji.

II.2. Procedura e shqyrtimit të ankesave

Procedura para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi fillon me plotësimin e një ankese. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitimë që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para Komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal (neni 33 i LMD). Ankesa duhet të ketë informacion lidhur me viktimën e diskriminimit, informacion mbi identifikimin e subjektit i cili pretendohet të ketë kryer diskriminim si dhe shpjegime dhe fakte që disponon lidhur me diskriminimin e pretenduar si dhe masat që kërkohen të merren nga Komisioneri.

Ankesa duhet të nënshkruhet nga personi apo përfaqësuesi i tij. Komisioneri nuk vepron për ankesat anonime.

Në qoftë se ankesa plotëson kushtet e ligjit për t'u pranuar ajo i nënshtrohet një shqyrtimi të mëtejshëm bazuar në nenin 33 të LMD. Procedura e hetimit përfshin grumbullim informacioni lidhur me çështjen, mund të zhvillohen edhe inspektime apo seanca dëgjimore mes palëve. Pas analizimit të fakteve të grumbulluara bazuar ne procedurën e hetimit, Komisioneri del me vendim brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së ankesës. Nëse gjatë procedurës administrative është, zhvilluar seancë dëgjimore, atëherë vendimmarrja e KMD zgjatet me 90 ditë të tjera. Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre. Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit.

Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

Si mjet të fundit, kur subjekti fizik ose juridik privat nuk i përmbahet vendimit të Komisionerit ose nuk e paguan gjobën brenda tre muajve pas afatit të caktuar nga Komisioneri dhe sanksioni nuk është kundërshtuar në gjykatë, Komisioneri mund t'u kërkojë autoriteteve kompetente heqjen apo pezullimin e lejes ose autorizimit të subjektit fizik ose juridik për ta ushtruar veprimtarinë e tij. Subjekti fizik ose juridik, ndaj të cilit merret masa ndëshkimore me gjobë, ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente, sipas Kodit të Procedurës Civile.

II.3. Çështjet e trajtuara[27] nga KMD gjatë vitit 2018

Në periudhën nga 1 janar 2018 deri në 31 Dhjetor 2018, KMD ka trajtuar gjithsej 287 çështje, (271 ankesa dhe 16 çështje ex-officio). Nga këto 205 çështje (197 ankesa dhe 8 çështje ex-officio) të regjistruara në vitin 2018, si dhe 82 çështje (74 ankesa dhe 8 çështje ex-officio) të mbartura nga viti 2017.

[27]Çështjet e mbyllura me vendim dhe ato në proces gjatë vitit 2018





Grafiku 1. Çështje të trajtuara në vitin 2018 *Grafiku 2. Çështje të regjistruara në vitin 2018*

II.4. Ankesat

Për periudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor 2018 pranë Komisionerit janë regjistruar **197 ankesa për t'u shqyrtuar** ndër të cilat:

- **52** (pesëdhjetë e dy) janë paraqitur pranë KMD, në Tiranë.
- **41** (dyzet e një) nga zyrat rajonale, konkretisht:
  - 18 (tetëmbëdhjetë) ankesa nga Zyra Rajonale Korçë
  - 13 (trembëdhjetë) ankesa nga Zyra Rajonale Gjirokastër
  - 10 (dhjetë) ankesa nga Zyra Rajonale Shkodër
- **68** (gjashtëdhjetë e tetë) kanë ardhur me postë.
- **36** (tridhjetë e gjashtë) kanë ardhur me e-mail në info@kmd.al dhe nëpërmjet aplikimit nga faqja zyrtare e KMD-së, www.kmd.al .



Grafiku 3. Ankesat e regjistruara gjatë vitit 2018, sipas mënyrës së paraqitjes pranë KMD-së

Në 11 raste ankesat nuk janë regjistruar, pasi subjektet ankues edhe pas kontaktimit nga përfaqësuesit e KMD-së, nuk kanë paraqitur kopje të letërnjoftimit. Këto raste janë ankesa të ardhura kryesisht nëpërmjet postës elektronike dhe në rrugë postare.[28]

Në analizë të numrit të ankesave të regjistruara në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, konstatohet se ka patur një rritje të numrit të ankesave me 15 %.



Grafiku 4. Ankesat e regjistruara nga viti 2010

II.5. Ankuesit

Bazuar në nenin 32, pika 1/a/b, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", ankuesit janë: individë, grupe individësh dhe organizata me interesa legjitime.

Nga 287 çështje që janë trajtuar gjatë vitit 2018, për 271 çështje ka filluar shqyrtimi në bazë të ankesës, nga të cilat në 232 raste ankesat janë paraqitur nga individë (166 ankesa të regjistruara gjatë vitit 2018 dhe 66 ankesa të mbartura nga 2017), në 26 raste ankesat janë paraqitur nga organizata me interesa legjitime (23 ankesa të regjistruara gjatë vitit 2018 dhe 3 ankesa të mbartura nga 2017), në 13 raste ankesat janë paraqitur nga grup personash (8 ankesa të regjistruara gjatë vitit 2018 dhe 5 ankesa të mbartura nga 2017).

[28]Për shkak se subjektet ankuese nuk kanë vënë në dispozicion të KMD-së argumentat, provat dhe informacionet përkatëse, për pranimin e ankesave të tyre edhe pas konstatimit nga ana e KMD-së. Pra, këto ankesa nuk kanë patur elementët thelbësor për t'iu nënshtruar procedurave të mëtejshme.



Grafiku 5. Sipas subjekteve ankues të trajtuara gjatë vitit 2018



Grafiku 6. Sipas subjekteve ankues të rregjistruar nga viti 2015



Grafiku 7. Ndarja sipas subjekteve për çështjet e trajtuara gjatë vitit 2018

Pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2018 përveç ankesave individuale, janë paraqitur edhe 26 ankesa nga organizata me interesa legjitim. Këto ankesa përgjithësisht kanë ardhur nga organizata që mbrojnë interesat e fëmijëve, komunitetit rom, egjiptian, PAK në fushën shërbimeve dhe të arsimit kryesisht. Vlen të theksohet fakti se, këto bashkëpunime kanë qenë mjaft të efektshme për evidentimin e rasteve të pretenduara për diskriminim, ndërgjegjësimin e përmirësimin e situatave. Në 23 raste ankuesit gjatë vitit 2018 janë asistuar nga organizatat e shoqërisë civile. Gjithashtu në disa raste informacioni i dhënë nga ana e organizatave të shoqërisë civile dhe media ka shërbyer si indicie apo informacion për Komisionerin për nisjen kryesisht të çështjeve.

II.6. Ex-officio (Çështje të nisura me iniciativën e KMD-së)

Mbështetur në nenin 32, pika 1/c, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", KMD ka nisur me iniciativë 8 raste pas marrjes së informacionit të besueshëm gjatë vitit 2018. Këto çështje, KMD i ka trajtuar mbështetur në informacionin e marrë nga organizata që veprojnë në fushën e diskriminimit. Organizatat të cilat kanë dhënë informacion për trajtimin e çështjeve me iniciativë, kanë qenë kryesisht me fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si p.sh. OJF: të cilat ofrojnë shërbim ligjor falas për persona në nevojë, në fushën e shërbimeve; të cilat ofrojnë shërbim dhe mbrojtje të personave me aftësi të kufizuara, si dhe organizata të cilat mbrojnë të drejtat e fëmijëve në arsim.



Grafiku 8. Çështjet ex-officio të trajtuara në vitin 2018

II.7. Shpërndarja e ankesave sipas Bashkive

Gjatë vitit 2018 ka patur një shtrirje të gjerë gjeografike të ankesave me pretendim diskriminim, të paraqitura pranë KMD-së. Bashkitë nga të cilat është paraqitur numri më i madh i ankesave janë: Tirana, Korça, Fieri, Berati, Gjirokastra, Elbasani, Vlora, Mati, Mallakastra, Çorovoda e zonat përreth tyre.



Grafiku 9. Shpërndarja e ankesave të regjistruara në vitin 2018 sipas Bashkive

II.8. Shkaqet e pretenduara në çështjet e shqyrtuara

Ligji nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", në nenin 1 të tij, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Në Zyrën e KMD-së, për vitin 2018 janë paraqitur ankesa për shkaqet e parashikuara në ligj, por ka patur dhe ankesa në të cilat subjektet nuk ishin në gjendje të identifikonin shkaqet. Duhet theksuar se LMD ka parashikuar një listë të hapur të shkaqeve duke përfshirë dhe rastet *"çdo shkak tjetër"*, duke patur parasysh këtu shkaqe që lidhen me cilësi apo karakteristika individuale të personave apo të një grupi të veçantë personash. Gjithashtu, theksohet se gjatë vitit 2018, janë paraqitur çështje në të cilat ankuesit kanë pretenduar më shumë se një shkak diskriminimi.

Më poshtë do gjeni të pasqyruar tabelën me shpërndarjen e ankesave të regjistruara në gjatë vitit 2018 të ndarë sipas shkaqeve:



Grafiku 10. Shkaqet e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2018



Grafiku 11. Shkaqet e ankesave të trajtuara gjatë vitit 2018

II.9. Fushat në të cilat janë paraqitur ankesat

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashikon 3 fusha të mëdha veprimi që gëzojnë mbrojtje: fusha e punësimit, fusha e arsimit, fusha e të mirave dhe shërbimeve. Gjatë vitit 2018, pranë zyrës së Komisionerit janë trajtuar gjithsej 287 çështje, (271 ankesa dhe 16 çështje ex-officio) nga të cilat 205 (197 ankesa dhe 8 çështje ex-officio) të regjistruara në vitin 2018.





Grafiku 12. Çështjet e trajtuara dhe të regjistruara gjatë vitit 2018, të ndara sipas fushave.

II.10.Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve

Ankesat në fushën e të mirave dhe shërbimeve kanë qenë të shumta në numër, pasi në këtë fushë përfshihen përfitimi i të mirave dhe shërbimeve të ofruar nga administrata publike dhe subjektet private. Kryesisht ankesat e paraqitura në këtë fushë kanë të bëjnë me shërbimet të cilat nuk janë ofruar nga njësitë vendore (p.sh. individ të komuniteteve në nevojë pretendojnë se njësitë vendore nuk u ofrojnë shërbimet), nga pushteti qendror si shëndetësia, administrata publike, subvencionimi i qirasë, përfitimin e ndihmës ekonomike, etj, si dhe nga subjekt private. Numri i përgjithshëm i tyre për vitin 2018, është 135, nga këto 118 kundër subjekteve publike dhe 17 kundër subjekteve private. Nga 118 ankesat e trajtuara kundër subjekteve publike, në 80 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe në 38 raste kundër institucioneve të pushtetit vendor. Përgjithësisht ankesat kanë pasur të bëjnë me përshtatjen e arsyeshme të banesave sociale, institucioneve publike, apo edhe përfitimin e shërbimeve publike. Kjo është dhe arsyeja pse kjo fushë përmbledh 42 % të ankesave të përgjithshme për vitin 2018.



Grafiku 13. Fusha e të mirave dhe shërbimeve

II.11. Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit

Ankesat e trajtuara me pretendim diskriminimin në fushën e punësimit janë ankesa të bëra kundër institucioneve shtetërore, po ashtu dhe kundër subjekteve private. Kryesisht ato kanë të bëjnë me procedurat e ndjekura prej tyre në lidhje me punësimin. Numri i përgjithshëm i tyre për vitin 2018, është 123, nga këto 99 kundër subjekteve publike dhe 24 kundër subjekteve private.

Nga 99 ankesat e trajtuara kundër subjekteve publike, në 87 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe në 12 raste kundër institucioneve të pushtetit vendor. Ankesat e paraqitura në fushën e punësimit, janë drejtuar përgjithësisht drejt institucioneve të administratës publike, si rezultat i largimit nga puna. Ankesat që janë trajtuar në fushën e punësimit kanë patur si shkak të pretenduar diskriminimi: bindjet politike, gjendjen shëndetësore, përkatësinë në një grupim të veçantë, gjendjen arsimore, moshën.



Grafiku 14. Fusha e punësimit

II.12. Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit

Gjatë vitit 2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar 29 çështje, në fushën e arsimit. Në 28 çështje të trajtuara në fushën e arsimit, ankuesit janë drejtuar kundër subjekteve publike dhe në 1 rast kundër një subjekti privat. Nga 28 ankesat e trajtuara kundër subjekteve publike, në 21 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe në 7 raste kundër institucioneve të pushtetit vendor. Rastet në fushën e arsimit kanë pasur përgjithësisht shkaqe diskriminimi racën, gjendjen shëndetësore, gjendjen ekonomike dhe aftësinë e kufizuar. Pjesa më e madhe e këtyre rasteve ka të bëjë me mospranimin e integrimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme dhe mospranimin e regjistrimit të fëmijëve të komunitetit rom/egjiptian në shkollat 9-vjeçare.



Grafiku 15. Fusha e arsimit

II.13. Ankesat e trajtuara me objekt mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Gjatë vitit 2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar 23 çështje (3 ex-officio dhe 20 ankesa) me subjekte fëmijët, ku 16 prej tyre janë mbyllur me vendim dhe për 7 vijon procedura se shqyrtimit në vitin 2019. Objekti i ankesave me subjekte fëmijët, kryesisht ka qenë:

- Pretendime mbi pamundësinë e komunitetit rom/egjiptian për të ndjekur shkollën për

shkak të gjendjes ekonomike,

- Pretendime lidhur me trajtimin me medikamente mjekësore falas,
- Pretendime mbi moszbatimin e legjislacionit për regjistrimin dhe trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë, duke i mohuar të drejtën e aksesit me mësues ndihmës,
- Pretendime lidhur me trajtimin e fyes ndaj një fëmije me aftësi të kufizuar nga ana e mësuesve të shkollës ku ai mëson.

II.14. Vendimet sipas fushave në të cilat janë paraqitur ankesat

Në fushën e të mirave dhe shërbimeve, KMD ka dhënë gjithsej 116 vendime nga të cilat, 100 kundër subjekteve publike dhe 16 kundër subjekteve private. Në këto vendime është konstatuar diskriminim në 19 raste, ku në 17 raste kundër subjekteve publike dhe 2 raste kundër subjekteve private.

Në fushën e punësimit, KMD ka dhënë gjithsej 94 vendime nga të cilat, 78 kundër subjekteve publike dhe 16 kundër subjekteve private. Në këto vendime është konstatuar diskriminim në 26 raste, ku në 20 raste kundër subjekteve publike dhe 6 raste kundër subjekteve private. Në vendimet kur është konstatuar diskriminim dhe në pjesën më të madhe të tyre Komisioneri ka rekomanduar dhe për rregullimet dhe masat që duhet të marrë subjekti i cili ka kryer diskriminimin (ku në shumë raste rezulton rikthimi i ankuesit në vendin e mëparshëm të punës).

Në fushën e arsimit, KMD ka dhënë gjithsej 22 vendime nga të cilat, 21 kundër subjekteve publike dhe 1 kundër një subjekti privat. Në këto vendime është konstatuar diskriminim në 5 raste, ku në 4 raste kundër subjekteve publike dhe 1 raste kundër subjekteve private.

II.15. Vendimet e çështjeve sipas shkaqeve

Vendimet e çështjeve me shkak racën[29]

Gjatë vitit 2018 ka përfunduar shqyrtimi për 43 çështje (nga këto, 28 çështje të mbartura nga viti 2017 dhe 15 çështje të regjistruara gjatë periudhës së raportimit) me pretendim diskriminimin për shkak të racës. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- në 6 çështje është dhënë vendim me diskriminim,
- në 17 çështje është konstatuar mosdiskriminim,

[29] Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 *"Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash".*

- në 4 çështje është pushuar ankesa për shkak se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin kishte nisur procedura hetimore,
- në 3 çështje procedura është pushuar për shkak se është bërë i pamundur sigurimi i provave për të marrë një vendim përfundimtar,
- në 1 çështje procedura e shqyrtimit është pushuar për shkak se ankuesi është tërhequr nga procedura hetimore,
- në 1 çështje procedura e shqyrtimit është pezulluar[30] për shkak se po hetohet nga organet e prokurorisë,
- në 12 çështje janë marrë vendime mospranimi[31],

Vihet re se, vazhdon të jetë i pranishëm diskriminimi i strukturuar që nuk i referohet një individi, por të gjithë grupit ose komunitetit. Nga analiza e bërë mbi rastet e trajtuara, evidentohet se anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian, nuk janë të mirë informuar për të drejtat dhe shërbimet që përfitojnë apo rrugët ligjore për të siguruar këto shërbime.

Gjithashtu, evidentohet një shtim i numrit të çështjeve në të cilat ankuesit pretendojnë diskriminim për më shumë se një shkak, si në rastin e sipërcituar, si dhe konstatime të diskriminimit në formë të shumëfishtë, pra për më shumë se një shkak, nga ana e subjekteve të ndryshme.



Grafiku 16. Vendimet e vitit 2018 me shkak racën

Vendimet e çështjeve me shkak aftësinë e kufizuar

Gjatë vitit 2018 ka përfunduar shqyrtimi për 23 çështje, për shkak të aftësisë së kufizuar. Nga këto:

- në 7 çështje është konstatuar diskriminim,

[30] Nuk është marrë një vendim përfundimtar.

[31] Gjithashtu gjatë vitit 2018 janë paraqitur një numër ankesash me shkak racën, të cilat nuk janë pranuar për shqyrtim, pasi nuk plotësonin kriteret që parashikon ligji 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, por për këto raste Komisioneri ka sugjeruar dhe rekomanduar që subjektet ankuese t'i drejtohen institucionit kompetent. KMD, në disa raste, ka ofruar asistencë për komunitetin rom dhe egjiptian, në plotësimin e dokumentacionit për përfitimin e ndihmës ekonomike, për regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkolla, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimin nga banesat sociale, dhe përfitimin nga tarifat studentore, etj.

- në 7 çështje është konstatuar mosdiskriminim,
- në 4 çështje është marrë vendim mospranimi,
- në 1 çështje procedura e shqyrtimit është pushuar për shkak se ankuesi është tërhequr nga procedura hetimore,
- në 4 çështje është marrë vendim pushimi, për shkak se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte nisur procedura hetimore.

Ankesat me pretendim diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar ndër të tjera kishin të bënin kryesisht me mohimin e përshtatjes së arsyeshme dhe ofrimin e të mirave dhe shërbimeve për fëmijët që ndjekin arsimin publik.

Vendimet e çështjeve me shkak bindjen politike

Gjatë vitit 2018 ka përfunduar shqyrtimi për 44 çështje, për shkak të bindjes politike. Nga këto:

- në 15 çështje është konstatuar diskriminim,
- në 14 çështje është konstatuar mosdiskriminim,
- në 1 çështje procedura e shqyrtimit është pushuar për shkak se ankuesi është tërhequr nga procedura hetimore,
- në 13 çështje janë marrë vendime mospranimi,
- në 1 çështje është marrë vendim pushimi, për shkak se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte nisur procedura hetimore.
- në 2 çështje procedura e shqyrtimit është pezulluar[32] për shkak se po hetohet nga organet e prokurorisë.

Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen ekonomike

Gjatë vitit 2018, ka përfunduar shqyrtimi për 25 çështje në të cilat pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike. Në analizë të çështjeve të trajtuara me këtë shkak, vlen të theksohet fakti që një pjesë e tyre kanë patur në objekt pretendimin për diskriminim për më shumë se një shkak. Në përfundim të procedurës së shqyrtimit:

- në 8 çështje është konstatuar diskriminim,
- në 5 çështje është konstatuar mosdiskriminim,
- në 8 çështje janë marrë vendime mospranimi,
- në 2 çështje procedura e shqyrtimit është pushuar për shkak se ankuesi është tërhequr nga procedura hetimore,
- në 1 çështje është vendosur pushimi pasi ka qenë i pamundur sigurimi i provave për trajtimin e mëtejshëm të ankesës,
- në 1 çështje janë dhënë rekomandime për përmirësimin e situatës

[32] Është marrë një vendim i ndërmjetëm dhe nuk është marrë një vendim përfundimtar.

Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen shëndetësore

Gjatë vitit 2018 ka përfunduar shqyrtimi për 11 çështje të trajtuara gjatë vitit 2018, në të cilat pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, nga të cilat:

- në 4 çështje është konstatuar diskriminim,
- në 2 çështje është konstatuar mosdiskriminim,
- në 5 çështje janë marrë vendime mospranimi

Vendimet e çështjeve ku në objekt të tyre kanë qenë fëmijët

Gjatë vitit 2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar 23 çështje (3 ex-officio dhe 20 ankesa) me subjekte fëmijët. Për 16 ankesa dhe 3 ex-officio, Komisioneri ka përfunduar procedurën e shqyrtimit, ku ka konstatuar:

- 3 vendime mosdiskriminimi,
- 2 vendime diskriminimi, të cilat janë zbatuar menjëherë nga ana e subjekteve ndaj të cilëve është paraqitur.
- 6 vendime për mospranimin e ankesës për shkak se nuk plotëson kriteret,
- 3 vendime pushimi për shkak se gjatë procedurave të hetimit, u arrit efektiviteti dhe qëllimi për të cilin kishte nisur shqyrtimi i ankesës.
- 1 vendim pushimi për shkak se gjatë procedurave të hetimit, subjekti ankues u tërhoq nga shqyrtimi i ankesës.
- 1 vendim pushimi për shkak të pamundësisë së sigurimit të provave dhe fakteve për të dalë me një vendim përfundimtar.

II.16. Rezultatet e vendimeve të ankesave të shqyrtuara

Duke u bazuar në nenin 33 të ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", fillimisht ankesat i janë nënshtruar një shqyrtimi paraprak, lidhur me kushtet e pranimit. Nëse ankesa nuk ka plotësuar kriteret e pranimit ose ka patur mungesë të informacionit që mund të pengojë procedurën e mëtejshme të shqyrtimit të saj, ankuesit i është kërkuar që të plotësojë kriteret e kërkuara nga LMD, për ta bërë atë të vlefshme. Kanë qenë të shumta rastet në të cilat, falë bashkëpunimit me përfaqësuesit e KMD-së, në Zyrat Rajonale të Korçës, Gjirokastrës dhe Shkodrës, si dhe organizatave të shoqërisë civile, subjekteve ankues u është ofruar asistencë, për plotësimin e saktë të formularëve të ankesës dhe dokumentacionit të nevojshëm, në përmbushje të kërkesave të ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2018 ka marrë 232 vendime për ankesat individuale dhe 2 rekomandime për çështje ex-officio, të cilat kanë patur në fokus një target grup të caktuar. Gjithashtu, Komisioneri në vijim të procedurave të shqyrtimit të ankesave, ka dhënë edhe 7 sanksione me gjobë, pra në total 239 vendime dhe 2 rekomandime. Nga këto:

- 49 vendime konstatim diskriminimi,

- 10 vendime për pushimin e çështjes, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin kishte nisur shqyrtimi i ankesave,
- 68 vendime konstatim mosdiskriminimi,
- 1 vendim për pushimin e çështjes, (për shkak se ankesat po shqyrtohen në Gjykatë),
- 91 vendime për mospranim të ankesës,
- 3 vendime për pezullimin e procedurave pasi të njëjtat fakte në përmbajtje të ankesave janë objekt hetimi në prokurori,
- 6 vendime pushimi për shkak të pamundësisë për të siguruar provat për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës,
- 4 vendime pushimi për shkak se ankuesit janë tërhequr nga procedura hetimore,
- 2 rekomandime të përgjithshme për përmirësimin e situatës, pas vendimit me diskriminim.

Janë vendosur 7 sanksione me gjobë	6 vendime për moszbatim vendimit të Komisionerit
	1 vendim për mosdhënie informacioni nga subjekti

Theksojmë faktin se në 10 çështjet e përfunduara ku është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin kishte nisur shqyrtimi i ankesave, situata diskriminuese e pretenduar është rregulluar gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, nëpërmjet hapave që KMD ka ndërmarrë në mbështetje të ligjit. Duke analizuar raportin vjetor të KMD-së për vitin 2017, ku ishin vetëm 4 vendime me arritje qëllimi, vërehet një rritje e numrit të këtyre vendimeve për shkak të ndërgjegjësimit të subjekteve ndaj të cilëve janë paraqitur ankesat. Gjithashtu vlen të theksohet se për vendimet me diskriminim të dhëna gjatë vitit 2018, mbas vendimit të dhënë nga KMD, në 11 raste subjektet kanë zbatuar rekomandimet për rregullimin e situatës diskriminuese të konstatuar.

Gjatë shqyrtimit të çështjeve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka dërguar 364 kërkesa për informacion ndaj palëve në proces dhe në vijim të shqyrtimit të ankesave ka zhvilluar 32 inspektime dhe 47 seanca dëgjimore publike, ku ka ftuar palët dhe çdo person tjetër të interesuar për të parashtruar pretendimet e tyre. Vlen të theksohet fakti që Komisioneri ka dalë me vendim diskriminimi për 21 raste, pas zhvillimit të seancave dëgjimore. Referuar raportit vjetor të vitit 2017, janë trefishuar rastet ku KMD, ka konstatuar situatë diskriminuese pas realizimit të seancave dëgjimore.

Veprimtaria e zhvilluar në kuadër të shqyrtimit të ankesave.	364 shkesa, kërkesë për informacion dërguar subjekteve.
	Janë organizuar 32 inspektime.
	Janë zhvilluar 47 seanca dëgjimore publike.

Referuar vendimeve të dhëna nga Komisioneri konstatohet se gjatë shqyrtimit të ankesave për vitin 2018, janë dhënë 49 vendime me konstatim diskriminimi, nga të cilat në 48 prej tyre është konstatuar në formën e diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe në 1 rast është konstatuar diskriminim i tërthortë. Vlen të theksohet se në 13 vendime subjekti ankues ka qenë grua, në 26 vendime subjekti ankues ka qenë burrë, në 3 vendime subjekti ankues ka qenë OJF, në 3 vendime subjekti ka qenë grup personash dhe në 4 vendime çështjet janë nisur kryesisht nga Komisioneri (ex-officio). Theksojmë faktin se 3 ndër vendimet e diskriminimit që janë konstatuar gjatë vitit 2018, kanë qenë lidhur me gjuhën e urrejtjes (**Hate speech**), të përdorur në portale, median e shkruar dhe atë vizive.

49 vendime me konstatim diskriminimi	13 vendime ku subjekti ankues ka qenë grua
	26 vendime ku subjekti ankues ka qenë burrë
	3 vendim ku subjekti ankues është OJF
	3 vendime ku subjekti ankues është grup personash
	4 vendime për çështje të nisura kryesisht

Vlen të theksohet fakti se KMD gjatë vendimeve të dhëna me diskriminimin gjatë vitit 2018, ka konstatuar në 10 raste diskriminimin e ankuesve për më shumë se një shkak (Diskriminimi i shumëfishtë). Krahasuar me vitin 2017, gjatë vitit 2018, janë trefishuar vendimet ku Komisioneri ka konstatuar diskriminim të subjekteve ankues për më shumë se një shkak.



Grafiku 17. Vendimet e dhëna gjatë vitit 2018



Grafiku 18. Vendimet e dhëna nga viti 2015

II.17. Proceset Gjyqësore

Pjesëmarrja në proceset gjyqësore

Gjatë vitit 2018, KMD ka marrë pjesë në 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) procese gjyqësore. Referuar statistikave të viteve të mëparshme, KMD vë re një rritje të ndjeshme të pjesëmarrjes në proceset gjyqësore. Më poshtë paraqiten në mënyrë tabelore, statistika krahasuese lidhur me pjesëmarrjen e KMD-së në proceset gjyqësore për periudhën 2012-2018 dhe roli i KMD-së në gjykim ndër vite.



Grafiku 19. Numri i proceseve gjyqësore nga viti 2012

Ligji "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" e vendos KMD në një raport të gjerë me gjykatën, duke parashikuar mjaft kompetenca përsa i takon pjesëmarrjes së institucionit në proceset gjyqësore. Vendimet e dhëna nga KMD janë të ankimueshme në gjykatë. Komisionerit i është dhënë kompetenca të përfaqësojë subjektet që pretendojnë se janë viktima të sjelljeve diskriminuese në gjykatë[33]. Gjithashtu, ligji parashikon detyrimin e gjykatës për ta njoftuar Komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim (Neni 36, pika 3) dhe ka të drejtë t'i kërkojë Komisionerit, që në çdo fazë të procedimit, të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen (Neni 36, pika 4 dhe neni 32, pika1/gj).

[33] Neni 34, pika 3 e Ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" përcakton se "*Një organizatë me interes të ligjshëm ose Komisioneri mund të paraqesë padi në emër të një personi ose grupi personash, me kusht që Komisioneri ose organizata të ketë pëlqimin me prokurë të posaçme ose me deklarim përpara gjykatës të personit ose grupit të personave të dëmtuar nga diskriminimi*".

Roli i KMD në proceset gjyqësore 2012- 2018 rezulton si më poshtë:



Grafiku 20. Roli i KMD-së në proceset gjyqësore nga viti 2012

Gjatë vitit 2018, KMD ka marrë pjesë në 66 procese gjyqësore, si:

- Palë e paditur në 33 (tridhjetë e tre) procese gjyqësore, ku kërkohet shfuqizimi apo pavlefshmëria e vendimeve të KMD-së, pra kur subjektet e gjetur në shkelje të ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" me vendim të KMD.
- Person i interesuar/palë e tretë në 27 (njëzetë e shtatë) procese gjyqësore, ku KMD është thirrur në gjykim nga gjykata kompetente, në çështje ku kërkohet dëmshpërblimi për diskriminim në gjykatë.
- KMD ka kërkuar lëshimin e 6 (gjashtë) Urdhrave të Ekzekutimit nga gjykata. Në përputhje me parashikimet ligjore, KMD i është drejtuar gjykatës me kërkesa për lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit, për vendimet me gjobë të KMD.

Statusi i KMD- së në proceset gjyqësore

KMD ka marrë pjesë në 66 procese gjyqësore:

- **33 procese si palë e paditur**
- **27 procese si palë e tretë**
- **6 kërkesa për urdhra ekzekutimi**

II.18. Vendimmarrja e Gjykatës

Gjatë vitit 2018, Gjykatat kompetente kanë dalë me 58 vendime për çështje ku KMD ka qenë palë, nga të cilat 44 vendime gjyqësore të dhëna nga gjykatat e shkallës së parë, civile dhe administrative dhe 8 vendime gjyqësore të dhëna nga gjykatat e apelit.
Në 44 vendimet gjyqësore të dhëna nga gjykatat, KMD ka qenë palë e paditur në 24 raste dhe palë e tretë në 20 raste.
Në çështjet ku KMD ka qenë palë e paditur në proces, gjykata ka marrë vendimet si më poshtë:

- 10 vendime për pranimin e padisë
- 1 vendim për pranimin e pjesshëm të padisë
- 13 vendime për rrëzimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimet e KMD

Në çështjet ku KMD ka qenë palë e tretë në proces, në paditë me objekt konstatim diskriminimi dhe dëmshpërblim, gjykata ka dhënë 20 vendime, nga të cilat:

- 11 vendime për pranimin e padisë, duke konstatuar diskriminimit dhe njohur dëmshpërblimin për diskriminim
- 8 vendime për rrëzimin e padisë
- 1 vendim për pushimin e gjykimit

Në 8 vendimet gjyqësore të dhëna nga Gjykatat e Apelit, KMD ka qënë palë e paditur në 4 raste dhe palë e tretë në 4 raste.
Në çështjet ku KMD ka qenë palë e paditur në proces, gjykata ka dhënë 4 vendime, nga të cilat:

- 1 vendime për pranimin e padisë
- 3 vendime për rrëzimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimet e KMD

Në çështjet ku KMD ka qenë palë e tretë në proces, në paditë me objekt konstatim diskriminimi dhe dëmshpërblim, gjykata ka dhënë 4 vendime, nga të cilat:

- 3 vendime për pranimin e padisë, duke konstatuar diskriminimin dhe njohur dëmshpërblimin për diskriminim
- 1 vendime për rrëzimin e padisë



Në çështjet ku KMD ka kërkuar lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit nga gjykata, kjo e fundit ka dhënë 6 vendime, nga të cilat:

- 5 vendime për pranimin e kërkesës dhe lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit
- 1 vendim për refuzimin e kërkesës për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit

Gjatë periudhës së raportimit, KMD ka vijuar ndjekjen e procedurave për ekzekutimin e vendimeve me gjobë, përmes përmbarimit publik, në 19 çështje.

II.19. KMD si palë e paditur, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimeve

Sa më poshtë paraqitet disa raste kur gjykatat kanë shqyrtuar ligjshmërinë e vendimeve të Komisionerit.

Çështje gjyqësore 1: *Gjykata konstaton ligjshmërinë e vendimmarrjes së Komisionerit, në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të gjendjes shëndetësore të ankuesit.*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga subjekti ankues A.Ç, ku pretendohej diskriminim, për shkak të "gjendjes shëndetësore", nga ana e Ujësjellës Kanalizime sh.a., Mat.

Ankuesi është punësuar pranë Ujësjellës Kanalizime sh.a., Mat, në pozicionin "specialist hidraulik + monovrator". Marrëdhënia e punës ka vazhduar nga data 20.03.2005 deri në datën 01.12.2017, moment në të cilin, kjo marrëdhënie pune është ndërprerë. Referuar nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatoi se marrja e vendimit për ndërprerje të marrëdhënieve të

punës në mënyrë të menjëhershme , ndaj subjektit ankues që ishte në gjendje mjekësore të rënduar, përbënte një veprim të padrejtë e disfavorizues kundrejt ankuesit. Komisioneri gjykoi se ankuesi A.Ç, ishte ekspozuar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, nga ana e Ujësjellës Kanalizime sh.a., Mat.

Në përfundim të hetimit administrativ, pasi ka disponuar informacionin e nevojshëm dhe ka vlerësuar në referim të ligjit situatën e ankuesit, Komisioneri me vendimin nr.190 datë 01.10.2018, vendosi konstatimin e diskriminimit, për shkak të "gjendjes shëndetësore dhe marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Ujësjellës Kanalizimeve sh.a., Mat, për sistemimin në punë të ankuesit. Ligjshmëria e vendimit të Komisionerit u bë konflikt gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Gjykata e Shkallës së Parë Administrative Tiranë, pasi shqyrtoi provat dhe faktet e paraqitura në gjykim nga palët ndërgjyqëse, në përfundim, me vendimin nr. 4602, datë 18.12.2018 vendosi rrëzimin e padisë duke konstatuara të drejtë vendimin e Komisionerit, si përsa i përket konstatimit të diskriminimit, ashtu edhe masës së marrë për rregullimin e pasojës, rikthimin në punë të ankuesit.

Çështje gjyqësore 2: *Gjykata konstaton ligjshmërinë e vendimmarrjes së Komisionerit, në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të bindjeve politike të ankuesit.*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga subjekti ankues H.D, kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim DPSHTRR), në të cilën pretendon diskriminim për shkak të bindjeve politike.

Ankuesi H.D ishte i punësuar pra DRSHTRR Tiranë në pozicionin "Anëtar i Komisionit të Marrjes në Prova Praktike", në Zyrën e Komisioneve për marrjen në prova praktike në Degën e Lejeve të Drejtimit në Drejtorinë Rajonale Tiranë. Marrëdhënia e punës ka vazhduar nga viti 2010 deri në datën 06.02.2018, kur është vendosur largimi nga detyra i ankuesit H.D, për shkak të riorganizimit të institucionit. Nga hetimi administrativ rezultoi se, ndërprerja e marrëdhënieve të punës midis ankuesit dhe punëdhënësit nuk kishte ardhur si rezultat i riorganizimit të institucionit, por se ankuesi ishte ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e punëdhënësit të tij, Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor, trajtim i cili kishte lidhje me bindjet politike të ankuesit.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri me vendimin nr. 179, datë 19.09.2018, vendosi konstatimin e diskriminimit, për shkak të "bindjeve politike" të ankuesit dhe marrjen e masave nga ana e DPSHTRR, për sistemimin në punë të ankuesit. Ligjshmëria e vendimit të Komisionerit u bë konflikt gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Gjykata e Shkallës së Parë Administrative Tiranë, pasi shqyrtoi provat dhe faktet e paraqitura në gjykim nga palët ndërgjyqëse, në përfundim, me vendimin nr. 4403, datë 04.12.2018 vendosi rrëzimin e padisë duke konstatuara të drejtë vendimin e Komisionerit, si përsa i përket konstatimit të diskriminimit, ashtu edhe masës së marrë për rregullimin e pasojës, rikthimin në punë të ankuesit.

Çështje gjyqësore 3: *Gjykata konstaton ligjshmërinë e vendimmarrjes së Komisionerit, në lidhje me trajtimin në kushte më pak të favorshme të personave që vuajnë dënimin në burgje*

apo ndodhen në paraburgim dhe janë të punësuar, krahasuar me kategorinë e punonjësve që punojnë dhe ndodhen jashtë këtyre institucioneve, duke iu mohuar atyre mundësinë për të përfituar sipas parashikimeve ligjore respektive.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), pas marrjes së informacionit nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, filloi procedurën për ndjekjen kryesisht të çështjes së njohjes të së drejtës së shpërblimit dhe mënyrës së përllogaritjes së punës për shtetasit e dënuar me heqje lirie.

Në analizë të çështjes, Komisioneri konstatoi se në gjithsej 23 burgje të RSH punonin një numër i konsiderueshëm i personave të dënuar me burgim. Ata nuk trajtoheshin nga administrata e burgjeve njësoj si shtetasit e tjerë të punësuar jashtë burgjeve, në përputhje me legjislacionin e punës apo të trajtimit të personave të burgosur (për të drejtën e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë në punë, kohëzgjatjes së punës, shpërblimit për punën, ditët e pushimit etj). U konstatua se, lidhur me punën e kryer nga të dënuarit në burgje ishin krijuar dy praktika: administrative dhe gjyqësore:

Një pjesë e personave të dënuar që punojnë në burgje shpërblehen sipas Vendimit nr.228, datë 19.05.1993 "Për mënyrën e shpërblimit të punës së të dënuarve me heqje lirie", të KM, duke u shpërblyer në shumën prej 90 (nëntë dhjetë) lekësh të rinj/muaj, megjithëse ky akt është miratuar para hyrjes në fuqi të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar. Ndërsa, sipas këtij ligji, të dënuarit që punojnë duhet të trajtohen sipas parashikimeve të Kodit të Punës dhe të paguhen me pagë minimale.

Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e të dënuarve me burgim që punojnë punë të ndryshme në burgje përfitojnë ulje dënimi rreth 3.9 ditë/muaj sipas Dekretit nr.7289, datë 08.04.1989 "Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje lirie, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën", të Presidiumit të Kuvendit Popullor.

Bazuar në Ligjin nr.8328/1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", Kodin e Punës, Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, VKM –në nr.396, datë 27.07.2000 "Për njohjen e periudhës së sigurimit për efekt pensioni dhe aksidenti në punë të të dënuarve me burgim", personat e dënuar që punojnë punë të ndryshme brenda organikës së burgut duhet të shpërblehen me pagë minimale, sipas kritereve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave. Në interpretim të parashikimeve ligjore, ata konsiderohen "punëmarrës" dhe duhet të trajtohen në përputhje me Kodin e Punës së Republikë së Shqipërisë, të ndryshuar. Megjithëse aktualisht në burgje punojnë një numër i konsiderueshëm i personave të dënuar me burgim, ata nuk trajtohen nga administrata e burgjeve njësoj si shtetasit e tjerë të punësuar jashtë burgut. Kjo sa i takon punësimit dhe trajtimit të tyre gjatë kësaj marrëdhënie, apo sa i takon të drejtës për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, kohëzgjatjes së punës, shpërblimit për punën, ditët e pushimit, etj.

Në këtë kuadër, Komisioneri me vendimin nr. 100, datë 05.04.2018, konstatoi se personat që vuajnë dënimin në burgje apo ndodhen në paraburgim dhe janë të punësuar pranë këtyre institucioneve, janë vënë në pozita jo të favorshme krahasuar me kategorinë e punonjësve që punojnë dhe ndodhen jashtë këtyre institucioneve, duke iu mohuar atyre mundësinë për të

përfituar sipas parashikimeve ligjore respektive. Ligjshmëria e vendimit të Komisionerit u bë konflikt gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi shqyrtoi provat dhe faktet e paraqitura në gjykim nga palët ndërgjyqëse, në përfundim, me vendimin nr. 4172, datë 19.11.2018 vendosi rrëzimin e padisë duke konstatuara të drejtë vendimin e Komisionerit për sa i përket konstatimit të diskriminimit personave që vuajnë dënimin në burgje apo ndodhen në paraburgim dhe janë të punësuar.

Çështje gjyqësore 4: *Gjykata konstaton ligjshmërinë e vendimmarrjes së Komisionerit, në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të gjinisë dhe përkatësisë në një grup të veçantë.*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga subjekti ankues A.B, ku pretendohej diskriminim, për shkak të "gjinisë" dhe "përkatësisë në një grup të veçantë" , nga ana e Rektorit të Universitetit të Tiranës.

Ankuesja është punësuar pranë Universitetit të Tiranës, që prej vitit 2009. Prej vitit 2016, ankuesja punonte në pozicionin e "Përgjegjëses së Sektorit Juridik", të Drejtorisë Juridike të Rektoratit të Universitetit të Tiranës. Më datë 19.12.2017, Rektori i UT ka vendosur zgjidhjen e menjëhershme, të marrëdhënies së punës me këtë punonjëse, me justifikimin se kishte konstatuar raste të përsëritura të shkeljeve gjatë kryerjes së punës dhe detyrave funksionale. Gjatë hetimit administrativ Komisioneri konstatoi dhe u vu në dijeni të konfliktit institucional brenda institucionit të Rektoratit dhe specifikisht konfliktit për kompetencë të Rektorit nga njëra anë dhe të Administratorit dhe Bordit të Administrimit të UT, nga ana tjetër. Kjo përballje mosmarrëveshjes kompetencash midis organeve drejtuese e reflektuar edhe me ndasi vendimmarrjesh kishin krijuar klimën dhe ekzistencën e dy grupeve punonjësish pranë Universitetit të Tiranës, si dhe pjesëmarrjen e ankueses në njërin prej këtyre grupeve.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri me vendimin nr. 145, datë 02.07.2018, vendosi konstatimin e diskriminimit, për shkak të "gjinisë" dhe përkatësisë në një grup të veçantë të ankueses duke vlerësuar se ndërprerja e marrëdhënieve të punës midis ankueses dhe punëdhënësit nuk kishte ndodhur për shkaqe të justifikuara, por se ankuesja ishte ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e punëdhënësit Rektorit të Universitetit të Tiranës, trajtim i cili kishte lidhje me gjininë dhe përkatësinë e ankueses në një grup të veçantë. Ligjshmëria e vendimit të Komisionerit u bë konflikt gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Gjykata e Shkallës së Parë Administrative Tiranë, pasi shqyrtoi provat dhe faktet e paraqitura në gjykim nga palët ndërgjyqëse, në përfundim, me vendimin nr. 4406, datë 04.12.2018 vlerësoi të drejtë vendimin e Komisionerit për konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues.

II.20. KMD si palë e tretë, në çështjet gjyqësore ku gjykatat kanë konstatuar diskriminimin dhe kanë njohur dëmshpërblimet përkatëse

Sa më poshtë paraqitet disa raste kur gjykatat kanë konstatuar diskriminim dhe kanë dhënë dëmshpërblimet përkatëse.

Çështja 1: *Gjykata konstaton diskriminimin në formën e "mohimit të një përshtatjeje të arsyeshme", ndaj të miturit me probleme të rënda dëgjimi dhe urdhëron ndreqjen e pasojave.*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë, në cilësinë e personit të tretë, në çështjen gjyqësore të të miturit G.L, i diagnostikuar me "Hypoacusia billateralis profonda, surdomutism", ose probleme të rënda dëgjimi, në të dy veshët.

I mituri G.L është protezuar me aparate dëgjimi konvencionale si dhe i është nënshtruar terapisë logopedike intensive, por nuk është vërejtur progres. Ndaj, në mungesë të efektivitetit të këtij mjekimi, Shërbimi i Kirurgjisë Infantile O.R.L pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, i ka rekomanduar pacientit të mitur, Implantimin Koklear (CI), një pajisje elektronike që implantohet në mënyrë kirurgjikale, si të vetmen zgjidhje për korrigjimin e problemit në dëgjim të të miturit.

Lidhur me pasojat, mos-sigurimi i kësaj pajisje rrezikon të shkaktojë pasoja të rënda lidhur me mundësinë e dëgjimit në të ardhmen.

Me VKM nr. 308, dt. 21.05.2014, "Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor", në fuqi që në muajin Qershor 2014, paketa e shërbimit të Implantit Koklear, përfshirë sigurimin e pajisjes dhe procedurën kirurgjikale për vendosjen e saj, sigurohet falas për pacientët që plotësojnë kushtet për përfitimin e saj. Institucionet përgjegjëse për paketën e shërbimit shëndetësor të Implantit Koklear janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për të siguruar aparaturën sipas standardeve të BE-së, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, për vlerësimin paraprak të gjendjes shëndetësorë të pacientit dhe ndërhyrjen kirurgjikale për implantimin, dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për financimin e procedurës kirurgjikale dhe monitorimin e ofrimit falas të kësaj pakete.

Në mendimin me shkrim të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe bazuar në nenin 3, pika 7, të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", rezulton se "rregullimi i domosdoshëm dhe i përshtatshëm" që nevojitet në rastin e të miturit G.L është sigurimi dhe vendosja e Implantit Koklear (CI), i cili nuk imponon një barrë të tepruar për institucionet përgjegjëse, pasi përcaktimi i detyrimit me akt nënligjor prezumon edhe mundësinë e financimit të pajisjes dhe procesit të implantimit. Mos-sigurimi i Implantimit Koklear (CI) dhe moskryerja e ndërhyrjes kirurgjikale, në një kohë sa më të shpejtë, për të miturin G.L, rezulton si pasojë e mosveprimit të institucioneve shëndetësore përgjegjëse dhe mos-marrjes së masave të duhura nga ana e tyre, sipas përgjegjësisë respektive të parashikuara në aktin nënligjor, VKM nr. 308 dt. 21.05.2014.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin Nr. 1250 (80-2018-1281), datë 10.04.2018, ka arsyetuar se mosveprimi i institucioneve përgjegjëse shëndetësore ka shkaktuar diskriminim ndaj të miturit G.L, në formën e "mohimit të një përshtatjeje të arsyeshme", duke urdhëruar marrjen e masave për dëmshpërblimin e dëmit të shkaktuar nga sjellja diskriminuese, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe pasojave të ardhura, përmes kryerjes së veprimeve për sigurimin dhe vendosjen e Implantit Koklear për të miturin G.L dhe kompensimin e dëmit shëndetësor në masën 6.838.590 lekë.

Çështja 2: *Gjykata konstaton diskriminim, ndaj L.M dhe urdhëron ndreqjen e pasojave.*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë, në cilësinë e personit të tretë, në çështjen gjyqësore të L.M, ish-punonjëse në një shoqëri aksionere, me objekt konstatimin e diskriminimit dhe dëmshpërblimin ndaj ish-punëdhënësit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi e ka shqyrtuar më parë administrativisht këtë çështje, nga ku ka rezultuar se:

L.M ka punuar rreth 10 vite në pozicionin e shefes së financës, në shoqërinë aksionere e cila i ka ndërprerë kontratën e punës, me motivin e suprimimit të pozicionit të punës, për shkak të ristrukturimit. Gjatë hetimit administrativ, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vlerësoi se veprimet e ndërmarra nga ana e shoqërisë aksionere, ishin dukshëm të njëanshme, në shkelje të këtij ligji. Trajtimi i disfavorshëm dhe i diferencuar i shtetases L.M, në raport me kolegët e saj, ishte haptazi diskriminues dhe mbi bazë preferencash gjinore. Fakti që shoqëria aksionere kishte rikthyer në punë të gjithë punonjës të gjinisë mashkullore, ishte tregues i diskriminimit të drejtpërdrejtë më bazë gjinore. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëpërmjet Vendimit Nr. 211, datë 30.12.2016, ka vendosur konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, për shkak të gjinisë, të shtetases L.M nga ana e ish-punëdhënësit, shoqërisë aksionere ku ajo punonte.

Pas shqyrtimit administrativ pranë Komisionerit, shtetasja L.M i'u drejtua gjykatës kompetente, me një padi civile, për rivendosjen e së drejtës së cenuar si dhe dëmshpërblimin jo-pasuror për dëmin e shkaktuar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me Vendimin Nr. 62-2018-1235 (313), datë 08.03.2018, ka vendosur pranimin e padisë, duke njohur diskriminimin e paditëses L.M, dhe detyrimin e palës së paditur, ish-punëdhënësit, të dëmshpërblejë palën paditëse për dëmin pasuror dhe jo-pasuror të pësuar, në vlerën totale 5.268.903 lekë.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 850, datë 18.10.2018, ka lënë në fuqi vendimin nr. 313, datë 08.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Çështja 3: *Gjykata konstaton diskriminim ndaj G.Y dhe familjarëve të tij dhe urdhëron ndreqjen e pasojave.*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë, në cilësinë e personit të tretë, në çështjen gjyqësore të G.Y, ish-punonjës në një shoqëri aksionere, dhe familjarëve të tij, me objekt konstatimin e diskriminimit dhe dëmshpërblimin nga ish-punëdhënësit.

Çështja nuk ka qenë objekt shqyrtimi administrativ nga ana e Komisionerit, pasi pala paditëse i është drejtuar gjykatës me padi për rivendosjen e së drejtës së cënuar. Në ligjin 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" parashikohet e drejta për t'u ankuar në rrugë gjyqësore, çdo personi ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim. Kjo e drejtë nuk kushtëzohet nga detyrimi për të ezauruar më parë ankimin përpara Komisionerit.

KMD, ka dhënë mendimin e tij me shkrim lidhur me çështjen, bazuar në njohuritë specifike të fushës së anti-diskriminimit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me Vendimin Nr. 174, datë 09.02.2018, ka vendosur konstatimin e faktit të diskriminimit dhe viktimizimit të paditësit G.Y dhe ndreqjen e shkeljeve ligjore, duke urdhëruar ish-punëdhënësin të dëmshpërblejë paditësit G.Y dhe familjarët e tij, për dëmin jo-pasuror, në vlerën 4.507.668 lekë.

Çështja 4: *Gjykata konstaton diskriminim ndaj F.M dhe urdhëron ndreqjen e pasojave.*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është thirrur, në cilësinë e personit të tretë, në çështjen gjyqësore të F.M, ish-drejtor në një drejtori rajonale, me objekt konstatimin e diskriminimit dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar, nga ish-punëdhënësi.

Çështja civile nuk ka qenë objekt shqyrtimi administrativ nga ana e Komisionerit, pasi pala paditëse i është drejtuar gjykatës me padi për rivendosjen e së drejtës së tij të cënuar. Në ligjin 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" parashikohet e drejta për t'u ankuar në rrugë gjyqësore, çdo personi ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim. Kjo e drejtë nuk kushtëzohet nga detyrimi për të ezauruar më parë ankimin përpara Komisionerit.

KMD, ka dhënë mendimin e tij me shkrim lidhur me çështjen, bazuar në njohuritë specifike të fushës së anti-diskriminimit dhe aktet gjyqësore.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me Vendimin Nr. 254, datë 21.03.2018, ka vendosur konstatimin e diskriminimit të paditësit F.M, në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme dhe detyrimin i ish-punëdhënësit të dëmshpërblejë me pagën e një muaji për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e marrëdhënies së punës dhe shpërblim të barabartë me pagën e gjashtë muajve, për zgjidhje të menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme të kontratës së punës, llogaritur në vlerën totale prej 714.119 lekë.

Çështja 5: *Gjykata konstaton diskriminim, ndaj A.SH dhe urdhëron ndreqjen e pasojave.*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë, në cilësinë e personit të tretë, në çështjen gjyqësore të A.SH, kundër Drejtorisë Rajonale Tiranë të F.S.D.K.Sh, me objekt konstatimin e diskriminimit dhe kërkim dëmshpërblimi si pasojë e diskriminimit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi e ka shqyrtuar më parë administrativisht këtë çështje, nga ku ka rezultuar se:

Ankuesja A.Sh ka filluar marrëdhëniet e punës me palën e paditur që prej vitit 1996. Për arsye shëndetësore në janar 2016 ankuesja ka marrë raport mjekësor. Në korrik 2016 është paraqitur në institucion për të rifilluar detyrën, por i është komunikuar që duhej të bënte kërkesë me shkrim për t'u rikthyer në detyre. Pas kërkesës me shkrim për rikthim në detyrë, me urdhër të titullarit të Drejtorisë Rajonale të Tiranë të F.S.D.K.Sh i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, me arsyetimin e mungesave të shumta të pajustifikuara në punë.

Në përfundim të proçedurave të shqyrtimit të ankesës Komisioneri ka konstatuar se shkak për shkëputjen e marrëdhënieve të punës ka qenë gjendja shëndetësore e ankueses A.Sh. Ndaj paditëses ka patur sjellje diskriminuese nga ana e D.R.F.S.D.K.SH Tiranë, pasi ekziston lidhja

shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi dhe trajtimit të pafavorshëm të paditëses, të pambështetur në arsye të ligjshme dhe objektive. Me vendimin Nr. 22, datë 19.04.2017, Komisioneri ka vendosur, konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë për shkak të gjendjes shëndetësore të ankueses A.Sh nga ana e Drejtorisë Rajonale të F.S.D.K.SH Tiranë.

Pas shqyrtimit administrativ nga Komisioneri, ankuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, për të kërkuar dëmshpërblimin për dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar si pasojë e diskriminimit.

Në vendimin nr. 3716 datë 19.10.2018, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, referuar ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, arsyeton se organi kompetent që konstaton nëse ka patur apo jo diskriminim është pikërisht Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në përfundim Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur, konstatimin e diskriminimit të A.Sh dhe detyrimin e punëdhënësit Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, të dëmshpërbleje A.Sh për dëmin pasuror dhe jopasuror, të pësuar nga diskriminimi i drejtpërdrejt për shkak të gjendjes shëndetësore në shumën 3.668.376 lekë.

Çështja 6: *Gjykata konstaton diskriminim, ndaj E.H dhe urdhëron ndreqjen e pasojave.*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë, në cilësinë e personit të tretë, në çështjen gjyqësore të E.H, ish-punonjëse në një sh.p.k., me pozicion financiere, me objekt konstatimin e diskriminimit dhe dëmshpërblimin ndaj ish-punëdhënësit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi e ka shqyrtuar më parë administrativisht këtë çështje, nga ku ka rezultuar se:

E.H ka punuar në pozicionin e financieres pranë Shoqërisë sh.p.k., bazuar në një kontratë pune me afat të caktuar. Rreth 6 muaj përpara mbarimit të afatit të kontratës, E.H i ka dhënë jetë vajzës së saj, në një lindje të parakohshme, në muajin e shtatë të shtatzënisë. Fëmija i lindur prematur, dy muajt e parë të jetës së tij i ka kaluar në inkubator. Gjatë kësaj periudhe, gjendja shëndetësore e nënës dhe fëmijës ka qenë kritike. Shoqëria i ka komunikuar zyrtarisht se kontrata e saj nuk do të rinovohej më pas përfundimit të afatit të caktuar në të, ndërkohë që E.H ishte me raport barrë-lindjeje, për më tepër që ajo kishte kaluar peripeci shëndetësore, për të cilat e kishte njoftuar punëdhënësin. E.H i ka kërkuar palës së paditur të kthehet në punë pas 45 ditësh pas lindjes, meqenëse kontrata e saj përfundonte pas rreth 4 muajsh, ndërkohë që përfaqësuesit e Shoqërisë i janë përgjigjur se ajo ishte zëvendësuar me dikë tjetër. Rezultoi se, një javë pasi E.H kishte dhënë jetë fëmijës së saj, Shoqëria kishte lidhur një kontratë të re pune, për një pozicion, për të cilin ishte në fuqi kontrata e punës me E.H.

KMD gjykoi se E.H, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga ish-punëdhënësi i saj, në krahasim me punonjës të tjerë të saj. Ky trajtim, ka lidhje të drejtpërdrejtë me gjininë e saj si femër, e cila është bërë nënë dhe si e tillë ka qenë e detyruar t'i përkushtohet fëmijës së saj, duke marrë lejen e lindjes, për shkak të paaftësisë së përkohshme në punë, leje e cila është e mbështetur në dispozitat përkatëse ligjore. Një fakt i tillë nuk është marrë në konsideratë nga Shoqëria., por E.H është diskriminuar, duke e njoftuar në një kohë të papërshtatshme për

zgjidhjen e kontratës së punës në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Punës, si dhe duke e zëvendësuar atë me një punonjës të seksit mashkull, me të cilin ka lidhur kontratë pune, në një kohë që kontrata e punës me E.H nuk kishte përfunduar ende.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëpërmjet Vendimit Nr. 146, datë 24.09.2014, ka vendosur konstatimin e diskriminimit, për shkak të gjinisë dhe paaftësisë së përkohshme në punë, të E.H, nga ana e ish –punëdhënësit, Shoqërisë ku ajo punonte.

Pas shqyrtimit administrativ nga ana e Komisionerit, shtetësja E.H i është drejtuar gjykatës kompetente, me një padi civile, për rivendosjen e së drejtës së cenuar si dhe dëmshpërblimin jo-pasuror për dëmin e shkaktuar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me Vendimin Nr. 152, datë 10.04.2018, ka konstatuar diskriminimin e paditëses E.H dhe ka vendosur detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen dhe familjarët e saj, për dëmin jo pasuror të pësuar, bazuar ne raportin psikologjik, në vlerën totale 6.046.326 lekë.

II.21. Rekomandime të Zyrës së KMD

Rekomandime për akte ligjore dhe nënligjore

Në zbatim të kompetencës ligjore të parashikuara nga neni 32, pika1, germa "ë", të ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", ku thuhet se: "Komisioneri ka kompetencë t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues", gjatë vitit 2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dhënë 13 rekomandime për akte ligjore dhe nënligjore, nga të cilat 2 rekomandime për akte ligjore dhe 11 rekomandime për akte nënligjore.

Skica e mëposhtme tregon numrin e Rekomandimeve Legjislative të KMD nga 2012-2018.



Grafiku 21. Numri i Rekomandimeve Legjislative nga viti 2012

Rekomandime për ndryshime në Ligjin "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"

KMD ka dërguar rekomandime Kuvendit mbi Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar. Propozimet e dërguara konsistojnë në këto drejtime kryesore:

- T'i kushtohet vëmendje e veçantë për mbrojtje edhe gruas. Standartet evropiane dhe ndërkombëtare me të cilat synon te përafrimi i këtij projektligji, e vendosin theksin specifikisht në dhunën dhe diskriminimin ndaj grave, prandaj specifikimi i tyre si një kategori veçanërisht e mbrojtur siç është bërë në projekt ligj për fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, të bëhet edhe për gratë.
- Të shtohet përkufizimi i "Dhunës ndaj Grave" me qëllim harmonizimin me nenin 3 të Konventës së Stambollit, pasi dhuna ndaj gruas parashikohet si formë e hapur diskriminimi. Komisioneri vlerësoi se, me këtë ligj duhet të gëzoj mbrojtje edhe Dhuna ndaj Grave, si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave, në kuptimin e Konventës.
- Të listohen shprehimisht në ligj shkaqet e mbrojtura nga diskriminimi, në mënyrë që ata të mund të identifikohen drejtpërdrejt në ligj, kuptohet duke u kujdesur që lista e shkaqeve të mbrojtura të jetë një listë joshteruese, në përputhje me parashikimin e Ligjit nr. 10221/2010 "për mbrojtjen nga diskriminimi".
- Riformulimi i pikës 4, të nenit 1 të projektligjit, sipas kësaj përmbajtje: "Masat mbrojtëse të parashikuara në nenin 10 të këtij ligji, si dhe ato të ndërmarra nga Policia e Shtetit nëpërmjet UPMM-së, në lidhje me kategoritë që gëzojnë mbrojtje të veçantë sipas pikës 2 të nenit 1, nuk konsiderohen diskriminim nëse zbatohen sipas kushteve të këtij ligji".

Rekomandime për projektligjin "Për strehimin social"

KMD ka dërguar rekomandime Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të Kuvendit të Shqipërisë, në kuadër të projektligjit "Për strehimin social". Më parë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i ka dërguar Ministrisë së Zhvillimit Urban (institucioni që mbulonte çështjet e strehimit), mendime për projektligjin "Për Programet Sociale te Strehimit", ku ka reflektuar komentet për zbatimin e parimit të mosdiskriminimit (neni 8 i projektligjit).

Pasi ka analizuar projektligjin "Për Programet Sociale te Strehimit", KMD ka dhënë mendim, si më poshtë citohet :

"... në kategoritë që kanë përparësi në përfitimin e subvencionit të qiranë, duhet të përfshihet edhe kategoria "të moshuar".

Në referencë të Ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", neni 3 pika 1: "Diskriminimi" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si

dhe me ligjet në fuqi. *"...mospërfshirja e kësaj kategorie, i vendos ata në pozita të trajtimit diskriminues krahasuar me kategoritë e tjera të përfshira në projektligj".*

Projektligji "Për strehimin social" i ardhur për mendim nga Kuvendi i Shqipërisë, me nismë të Këshillit të Ministrave, e ka marrë parasysh qasjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të çështjes së strehimit social.

Konsiderojmë se, në këtë projektligj, respektimi i të drejtës për strehim garanton standartet e barazisë dhe mos-diskriminimit, të cilat janë përqasur në legjislacionin e brendshëm shqiptar.

Rekomandime për projekt-vendimet në zbatim të ligjit "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"

KMD ka dërguar rekomandime Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lidhur me projekt-vendimet e Këshillit të Ministrave, hartuar në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", si më poshtë vijon:

1. Projekt-vendimi i Këshillit të Ministrave "Për llojet, mënyrën e shkëmbimit dhe të përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore, të kërkuara nga agjencia pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor".
2. Projekt-vendimi i Këshillit të Ministrave "Për kriteret për punësimin e punonjësve të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe të punonjësve të cilët punojnë me fëmijët".
3. Projekt-vendimi i Këshillit të Ministrave "Për veprimtarinë e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje më fëmijën nën moshën e përgjegjësisë penale që dyshohet apo ka kryer vepër penale ".

Rekomandime për Projekt-vendimet në zbatim të ligjit "Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare"

KMD ka dërguar rekomandime Ministrisë së Arsimit dhe Sportit lidhur me projekt-vendimet, hartuar në bazë dhe për zbatim të ligjit 96 / 2017 "Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare", si më poshtë vijon:

1. Projekt – vendimi "Për masat e përshtatshme për nxitjen e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë arsimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë"
2. Projekt – vendimi "Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimin e klasave mësimore në gjuhën e pakicave kombëtare"
3. Projekt – vendimi "Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrin thelbësor dhe kërkesën e mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare, për t'u mësuar gjuhën e pakicës"

Gjithashtu, KMD ka dërguar rekomandime Ministrisë së Kulturës, lidhur me një Projekt-vendim, hartuar në bazë dhe për zbatim të ligjit 96 / 2017 "Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare", si më poshtë vijon:

1. Projekt – vendimi "Për përcaktimin e Strategjive , programeve dhe planeve të veprimit për të krijuar kushtet e nevojshme që pakicat kombëtare të ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre të dallueshëm në Republikën e Shqipërisë"
2. Projekt – vendimi "Për përcaktimin e masave dhe politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike të tyre në Republikën e Shqipërisë".

Rekomandime për projektvendimin "Për miratimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit dhe Planin e Veprimit ".

KMD ka dërguar rekomandime Ministrisë së Drejtësisë lidhur me projekt-vendimin "Për miratimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit dhe Planin e Veprimit ", duke i rekomanduar që:

- Strategjia e Drejtësisë për të Miturit dhe Plani i Veprimit të përbmajë objektiva dhe aktivitete me qëllim për të adresuar nevojën për mbrojtje të posaçme të fëmijëve që janë më vulnerabël, e në mënyrë të veçantë detyrimin për të garantuar aksesueshmërinë për fëmijët me aftësi të kufizuar.
- Të përcaktohen indikatorë konkretë për zbatimin e këtyre objektivave dhe aktiviteteve.

Rekomandime për Strategjinë Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit dhe Plani i Veprimit, 2019 – 2022.

KMD ka dërguar rekomandime Ministrisë së Brendshme lidhur me Strategjinë Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit dhe Plani i Veprimit, 2019 – 2022, duke adresuar nevojën për një mbrojtje të posaçme të personave me aftësi të kufizuara dhe personave të moshuar.

- Rekomandime për Projekt Rezolutën e Kuvendit "Për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut, në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë."

KMD i ka dërguar rekomandime Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pranë Kuvendit të Shqipërisë, lidhur me projekt-rezolutën "Për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut, në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë.", duke rekomanduar:

1. Shtimin e grupeve të veçanta të mbrojtësve të të drejtave, duke përfshirë jo vetëm gratë, LGBTI, por edhe mbrojtësit e të drejtave fëmijëve, të personave me aftësi të kufizuara, viktimave të dhunës dhe trafikimit.
2. Kur referohet tek komunitetet e pakicave kombëtare , rezoluta duhet të pasqyrojë se brenda këtyre komuniteteve një kujdes i veçantë kërkohet për komunitetet e pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane.
3. Rezoluta duhet të përcaktojë një afat se kur do të miratohet Plani i Veprimit për zbatimin e Rezolutës.

4. Rezoluta duhet të këtë një parashikim në lidhje me marrjen e masave për të mbrojtur mbrojtësit e të drejtave jo vetëm nga sulmet apo ngacmimet e bëra nga zyrtarë publikë por edhe nga aktorë të tjerë jo-shtetërorë. Ky rekomandim bazohen në parashikimet që kanë bërë Rezoluta 2225 (2018), Rekomandimi 2085 (2016) dhe Rezoluta 2095 (2016) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, të cilat vendosin një theks të veçantë tek fakti se, shtetet duhet të marrin masa për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut edhe nga sulmet ose ngacmimet nga aktorët jo-shtetërorë.
5. Rezoluta duhet të parashikojë që standarti i bashkëpunimit që duhet të ndiqet me organizatat e shoqërisë civile për hartimin e Strategjisë Kombëtare dhe Plan Veprimit Ndërministror për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, duhet të garantojë jo vetëm përfshirjen dhe konsultimit në përgjithësi, por edhe një rol në vendimmarrjen finale". Ky standart do të garantonte më mirë dhe në mënyrë më efektive, të drejtat e secilës palë të përfshirë në këtë bashkëpunim, në mënyrë të veçantë të mbrojtësve të të drejtave të njeriut.

Rekomandime për çështje të veçanta

Në zbatim të kompetencës ligjore të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin gjatë vitit 2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dhënë rekomandimet e mëposhtme për çështje të veçanta.

Rekomandime për fëmijët në Institucionet Rezidenciale

KMD ka dërguar Shërbimit Social Shtetëror dhe Shtëpive të Fëmijës, sipas grupmoshave, në Shkodër, Tiranë, Korçë, Vlorë, Sarandë dhe Durrës, "Rekomandime lidhur me trajtimin e rasteve me fleksibilitet kur prindërit/kujdestare ligjore kërkojnë të marrin fëmijët përkohësisht nga Institucionet rezidenciale", përmes shkresës Nr.491 Prot datë 05.04.2018.

Në analizimin e kësaj problematike, KMD ka vlerësuar se, pavarësisht parashikimeve ligjore, institucionet rezidenciale për fëmijë duhet të kenë një praktikë më të zbutur dhe duhet treguar më tepër fleksibilitet , në rastet kur prindërit , kërkojnë marrjen përkohësisht të fëmijëve të tyre që kanë në kujdestari ligjore, por që marrin shërbim në qendër përkujdesi.

Gjithashtu, KMD ka vlerësuar se nuk mund të ndalohen prindërit të marrin përkohësisht fëmijët e tyre, që jetojnë në qendër rezidenciale edhe nëse nuk provojnë dot përmirësim të gjendjes sociale – ekonomike. Në këto raste, vendimmarrja duhet të bëhet rast pas rasti duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës.

Në përfundim, KMD i ka rekomanduar institucioneve të sipërcituara, marrjen e masave për rritjen e fleksibilitetit në trajtimin e rasteve, kur prindërit kërkojnë të marrin përkohësisht fëmijët e tyre nga Institucionet Rezidenciale edhe në rastet kur vlerësimi social – ekonomik nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës/ administratori shoqëror nuk parashtron përmirësim të kushteve.

Rekomandim për marrjen e masave për të garantuar pa diskriminim dhe brenda afateve efektive, të drejtën për arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, përmes arsimit gjithëpërfshirës, në arsimin parauniversitar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë muajit gusht 2018, i ka dërguar rekomandim Ministrisë së Arsimit dhe Sportit duke i kërkuar:

- Marrjen e masave të menjëhershme për të siguruar ngritjen dhe funksionimin e Komisioneve Multidisiplinare në nivel DAR/ZA, si dhe Komisionet në institucionet arsimore të zakonshme.
- Përcaktimin e rregullave dhe procedurave për funksionimin e komisioneve si më sipër, si dhe përcaktimin e detyrimeve dhe përgjegjësive për mospërmbushjen e detyrimit për ngritjen dhe funksionimin e Komisioneve Multidisiplinare, si në nivel DAR/ZA ashtu edhe në nivel shkolle.
- Marrjen e masave të menjëhershme, për përgatitjen e Planeve Edukative Individuale (PEI), sipas nevojave të vlerësuara të fëmijëve me aftësi të kufizuara nga komisionet multidisiplinare.
- Marrjen e masave për mbështetjen me mësues ndihmës të kualifikuar sipas nevojave të vlerësuara të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Marrjen e masave për të siguruar një monitorim të vazhdueshëm dhe proaktiv të procesit të arsimit gjithpërfshirës, me qëllim eliminimin e barrierave që pengojnë të drejtën për arsimim, të fëmijëve me aftësi të kufizuara, për të përshtatur nevojat dhe për të garantuar përfshirjen efektive të fëmijëve.
- Marrjen e masave për të garantuar mbrojtjen nga diskriminimi në mënyrë të veçantë për vajzat me aftësi të kufizuara, si dhe për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuar, që i përkasin grupeve të disavantazhuara, siç janë fëmijët me aftësi të kufizuar rome, egjiptianë, fëmijët me aftësi të kufizuara nga familjet e varfra. Këto kategori fëmijësh janë të rrezikuar për të përjetuar situata diskriminuese më të rënda, për pasojë të ndërveprimit apo mbivendosjes së më shumë se një shkaku të mbrojtur.
- Me qëllim që të gjitha masat e mësipërme të jenë efektive, veçanërisht për vitin shkollor 2018-2019, vlerësojmë se ato duhet të realizohen në një kohë sa më të shkurtër, por jo më vonë se fundi i muajit shtator 2018.

Rekomandim në lidhje me strehimin e familjeve rome dhe egjiptiane, në zonën e Selitës, Tiranë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori dijeni për shqetësimin e disa familjeve rome dhe egjiptiane34, banesat e të cilëve u prekën nga një investim publik (ndërtimi i unazës së madhe në zonën e Selitës, Tiranë). Pasi shqyrtoi situatën, KMD ka dërguar rekomandim

[34] Këto familje u trajtuan me qira 3 vjeçare në bazë të VKM-së nr. 230, datë 13.03.2015 *"Për trajtimin me pagesë të qirave për disa familje që preken nga zbatimi i projektit: Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës",* të ndryshuar[34]. Afati i trajtimit me qira sipas VKM nr. 230, datë 13.03.2015, të ndryshuar, kishte përfunduar në mars 2018.

Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkisë Tiranë, për marrjen e masave si më poshtë:

- Marrjen e masave nga ana e institucioneve përgjegjëse sipas fushave të tyre të kompetencave dhe përgjegjësive, për sigurimin e strehimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë të familjeve të komunitetit rom dhe egjiptian, të cilat kanë mbetur të pastreha si rezultat i zbatimit të projektit "Unaza e madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës".
- Marrjen e masave nga ana e institucioneve përgjegjëse sipas fushave të tyre të kompetencave dhe përgjegjësive, për të siguruar vazhdimin e trajtimit me pagesë qiraje deri në sistemimin me strehim në një nga programet që parashikon ligji për strehimin, të familjeve të cilat janë trajtuar në bazë të VKM nr. 230, datë 13.05.2015 "Për trajtimin me pagesë të qirave për disa familje që preken nga zbatimi i projektit: Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës", të ndryshuar.
- Marrjen e masave nga ana e institucioneve përgjegjëse sipas fushave të tyre të kompetencave dhe përgjegjësive, për koordinimin dhe lehtësimin e procesit, si dhe mbledhjen e dokumentacionit të kërkuar për të aplikuar në programet që parashikon ligji për strehimin, për familjet të cilat janë trajtuar sipas VKM nr. 230, datë 13.05.2015, të ndryshuar, deri në sistemimin e tyre në një nga programet e strehimit të parashikuar nga ligji.

Rekomandim për marrjen e masave në lidhje me çështjen e e regjistrimit të lejes së legalizimit dhe nxjerrjen e çertifikatës së pronësisë në emër të të dy bashkëshortëve ose ish-bashkëshortëve.

KMD ka dërguar rekomandim Ministrisë së Drejtësisë, Agjensisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme duke rekomanduar sa më poshtë vijon:

- Marrjen e masave nga ana e institucioneve përgjegjëse, sipas fushave të tyre të kompetencave dhe përgjegjësive, duke ndaluar praktikat e nxjerrjes së çertifikatës së pronësisë si dhe të lejeve të legalizimit në emër vetëm të "kryefamiljarit", në regjimin pasuror të bashkësisë ligjore.
- Marrjen e masave nga ana e institucioneve përgjegjëse, sipas fushave të tyre të kompetencave dhe përgjegjësive të unifikojnë praktikat mbi regjistrimin e pronave informale dhe nxjerrjen e çertifikatave të pronësisë, duke shmangur qëndrimet diskriminuese për shkak të gjinisë.

II.22. Ndërgjegjësimi

Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të KMD-së, parashikuar përmes një serë kompetencash për këtë qëllim si:

- Nxitja e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuar; adresimi drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- Informimi për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje;
- Zhvillimi i dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

Spote publicitare të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Një formë e re e ndërgjegjësimit të opinionit publik dhe qasjes së këtij të fundit ndaj Zyrës së KMD, është edhe realizimi i 80 spoteve televizive, të shfaqura për 8 javë (2 muaj), në 2 televizione kombëtare, me shikueshmëri të lartë, siç është RTSH dhe Top Channel.

Në këto spote janë pasqyruar për publikun 8 raste suksesi të vendimeve të Komisionerit, të pranuara nga gjykata dhe zbatuara nga institucionet.

Spotet televizive janë fryt i mbështetjes dhe bashkëpunimit të suksesshëm të Zyrës së KMD me Zyrën e Këshillit të Evropës (CoE), në Tiranë.

Shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuese

Informimi dhe ndërgjegjësimi i opinionit publik është prioritet i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Këtë detyrë KMD ë ka përmbushur edhe përmes shpërndarjes së publikimeve të veta në çdo institucion publik dhe jopublik në Tiranë dhe në rrethe.
Gjatë gjithë muajit maj, sete të botimeve të Zyrës së KMD, janë dërguar në të gjitha Bashkitë e rretheve në vend. Po ashtu, këto publikime janë dërguar në të gjitha Universitetet e vendit; në Gjykatat e Tiranës dhe rretheve; në Ministritë e linjës dhe Institucionetet e Pavarura.
Duke filluar nga muaji maj, KMD dërgon nëpërmjet postës elektronike, pranë institucioneve publike shqiptare, organizatave të huaja dhe përfaqësive diplomatike në Shqipëri, përmbledhësen (news letter) të veprimtarisë mujore së tij.
Në të gjitha aktivitetet ndërgjegjësuese të zhvilluara gjatë vitit 2018, Zyra e KMD ka shpërndarë për njohje dhe informim më të zgjeruar, publikime të ndryshme, me fokus njohjen e ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" si dhe njohjen e aktivitetit të kësaj Zyre, që prej fillimeve të saj, në vitin 2010.

Pjesëmarrja e Zyrës së Komisionerit në aktivitete ndërgjegjësuese

Me qëllim zbatimin e ligjit dhe përmbushjen e misionit për nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, Komisioneri ka zhvilluar një sërë aktivitetesh sensibilizuese e ndërgjegjësuese për opinionin publik.

- Më 8 shkurt dhe 6 Mars u organizuar pranë ambienteve të KMD-së takim informues me shoqatën "Vish këpucët e mia" ku u njohën me ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi", rolin e Komisionerit në promovimin e parimit të barazisë dhe mbrojtjen e viktimave nga sjelljet diskriminuese, mënyrën e ankimit dhe procedurat e shqyrtimit të çështjeve pranë KMD-së dhe në gjykatë.
- Më 4 prill, Komisioneri, së bashku me përfaqësuesit e Zyrave Rajonale të Komisionerit në Korçë, Gjirokastër dhe Shkodër, morën pjesë në aktivitetin e organizuar nga projekti "*Shkolla ime - shkolla jote*", në shkollën "Ismail Qemali" në Korçë, me temë "*Gjithpërfshirja e Fëmijëve Rom dhe Egjiptian në Sistemin Arsimor*".
- Më 13 maj, Komisioneri mori pjesë në ecjen vjetore me biçikleta në Tiranë në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë, Aleanca LGBT dhe Pro LGBT.
- Më 17 maj, Komisioneri mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga PINK Embassy, me qëllim prezantimin e raport-monitorimit të Planit Kombëtar për LGBT.
- Më 18 maj, Komisioneri mori pjesë në aktivitetin mbi "*Aspekte të Aksesit në Shëndetësi dhe Mbrojtjes nga Diskriminimi për Grupet Vulnerabël",* të organizuar nga Civil Rights Defenders Albania, me mbështetjen e Qeverisë së Suedisë.
- Më 23 maj, përfaqësuesja e Zyrës së Komisionerit në Korçë mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Universiteti i Korçës, në kuadër të Ditës Botërore për Diversitetin Kulturor për Dialogun dhe Zhvillimin.
- Më 25 maj, stafi i Kmd-së mori pjesë në aktivitetin "*Perceptimet dhe Qëndrimet e Mësuesve ndaj adoleshentëve LGBTI në shkollat publike në Shqipëri*", organizuar nga Ambasada Pink.
- Më datë 1 qershor, Komisioneri mori pjesë në aktivitetin *"Miqtë e Fëmijëve",* zhvilluar në ambjentet e Kuvendit të Shqipërisë.
- Më datë 5 qershor, Komisioneri priti koordinatorin e OKB-së, z. Brayan Williams pranë zyrave të KMD-së, me të cilin diskutuan bashkëpunimin e mëtejshëm për sfidat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.
- Më 6 qershor, Komisioneri mori pjesë në aktivitetin me temë *"Të luftojmë diskriminimin dhe krijimin e urrejtjes në Shqipëri",* organizuar nga Ambasada Hollandeze.
- Më 6 qershor, Komisioneri mori pjesë në aktivitetin "*Lufta kundër Diskriminimit dhe Mbrojtja e të drejtave të LGBTI në Shqipëri*", organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.
- Më 11 qershor, Komisioneri mori pjesë në dialogun publik për "Planin Kombëtar të Veprimit Për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020".
- Më 22 qershor, Komisioneri mori pjesë në aktivitetin e PNUD (UNDP), për fuqizimin e komunitetit egjiptian "*Inkubatori i Identitetit të të Rinjve Egjiptianë*" në Durrës.

- Më 26 -29 qershor, Komisioneri dhe stafi morën pjesë në "*Forcimi i Kapaciteteve të fëmijëve dhe të rinjve për të advokuar për të drejtat e tyre*".
- Më 28 qershor, Komisioneri prezantoi misionin e KMD-së dhe sfidën e luftës ndaj diskriminimit dhe promovimin e parimit të barazisë, një grupi të madh të rinjsh nga disa qytete të vendit, në trajnimin e "*Forcimit të kapaciteteve të fëmijëve dhe të rinjve për te advokuar për të drejtat e tyre*", organizuar nga Save the Children, Children's Human Rights Centre of Albania - CRCA Albania dhe Fondacioni Ivanaj.
- Më 26 qershor, një nga punonjësit e KMD-së mori pjesë në takimin "*Të gjithë së bashku për drejtësinë e Enea Ftoj*", organizuar nga Unioni për Zhvillim dhe Integrim të Minoritetit Rom në Shqipëri "Amaro-Drom".
- Më 2 gusht, Zyra Rajonale Shkodër, zhvilloi një seancë trajnuese me kursantët që ndjekin formimit profesional pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik ne qytetin e Shkodrës.
- Më 25 shtator, në javën Ndërkombëtare të Personave që nuk Dëgjojnë, Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD), në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur nga Shoqata e Njerëzve që nuk Dëgjojnë në Finlandë, FAD, organizuan aktivitetin me temë: *"Me gjuhën e shenjave gjithkush është i përfshirë"*.
- Më 11 tetor, Komisioneri iu bashkua nismës "Samiti i vajzave" të organizuar nga disa shoqata të shoqërisë civile, me synim fuqizimin e grave dhe vajzave në shoqërinë shqiptare dhe mobilizimin e figurave vendimmarrëse të politikës dhe jetës publike për arritjen e këtij objektivi.
- Më 12 tetor, Komisioneri mori pjesë në aktivitetin e quajtur *"#5Tullat"*, të organizuara nga Komunitetit Zëri i Integrimit, një platformë inovative që bën bashkë profesionistët e rinj dhe kontributin vullnetar për prioritetet e BE për Shqipërinë dhe në veçanti mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Më 22 tetor, Komisioneri mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Qendra "Tirana Art" në bashkëpunim me Ambasadën e Vendeve të Ulta në Shqipëri, "Handle with Care!".
- Më 24 tetor, Komisioneri në bashkëpunim me përfaqësuesit e komunitetit egjiptian, Kryqi Kuq Shqiptar, si dhe stafi mjekësor i bankës së Gjakut në QSUT, morën pjesë në një seancë dhurimi gjaku pranë institucionit të KMD, duke iu bashkuar nismës "Aleanca për Dhurimin e Gjakut" e drejtuar nga Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta.
- Në 3 dhjetor, Komisioneri mori pjesë në aktivitetin e organizatës "World Vision Albania" për Ditën Ndërkombëtare për personat me aftësi të Kufizuar në Korçë dhe Maliq, posaçërisht në Shkollën 9-të vjeçare në Pojan.
- Më 5 dhjetor, Komisioneri zhvilloi një sesion informimi me temë: "Edukimi dhe Fuqizimi i Komunitetit Rom përmes të Drejtës së Informimit për të Aksesuar Sistemin e Drejtësisë", në Lushnje, të organizuar nga shoqata "Rromano Kham", "Qendra e Praktikave dhe Shërbimeve Ligjore" dhe "Save the Children".
- Në 5 dhe 7 dhjetor, Komisioneri dhe stafi i tij, zhvilloi në qytetet Lushnjë dhe Pogradec një sesion informimi me temë: "*Edukimi dhe Fuqizimi i Komunitetit Rom përmes të Drejtës së Informimit për të Aksesuar Sistemin e Drejtësisë*", të organizuar nga shoqata Rromano Kham," Qendra e praktikave dhe Shërbimeve ligjore" dhe organizata "Save the Children".

- Më 14 dhjetor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Korçë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kujdesit Social-Bashkia Korçë dhe shkollat e qytetit, zhvilluan një takim informues me mësues, prindër dhe koordinatorët e barazisë gjinore mbi praktikat më të dobishme për arritjen e objektivave socialë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Më 20 nëntor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka organizuar një takim me përfaqësues të Zyrës për Ndihmë Ligjore Falas, me bashkëpunimin e ndërsjelltë lidhur me trajtimin e rasteve të diskriminimit.
- Më 20 dhjetor përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka marrë pjesë në takimin informues zhvilluar në shkollën "Lucë Agraja", njësia administrative Dajç, Bashkia Shkodër, me objekt njohjen e ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".

Pjesëmarrja e Zyrës së Komisionerit në aktivitete institucionale

Me qëllim forcimin e bashkëpunimit me institucionet shtetërore, organizatat brenda dhe jashtë vendit, që punojnë në mbrojtje të të drejtave të njeriut, Zyra e KMD dhe Komisioneri kanë qenë pjesë e një sërë aktivitetesh, si: takime pune, seminare, trajnime, tryeza diskutimi dhe grupe pune.

- Më 24-25 janar, stafi i KMD-së ka marrë pjesë në trajnimin me temë: "Rregullorja dhe procedurat e brendshme të KMD-së", organizuar nga Këshilli i Evropës.
- Më 30 janar, një nga punonjësit e KMD-së, mori pjesë në takimin me temë: "*Përfshirja e personave me aftësi të kufizuar në proçeset e informimit dhe konsultimit publik",* organizuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.
- Më 6 prill, grupi i punës së PBA-së nga KMD, mori pjesënë trajnim për "*Buxhetimin Gjinor*" në kuadër të Projektit "*Përfshirja e parimeve të barazisë gjinore në sistemin e menaxhimit të financave publike*".
- Më datë 6 prill, Komisioneri ishte i pranishëm në Forumin e Shoqërisë Civile "Pjesëmarrja Politike e Personave LGBTI në Shqipëri", zhvilluar në ambientet e Kuvendit të Shqipërisë.
- Më 16 prill, një nga punonjësit e KMD-së, mori pjesë në takimin me temë: *"Vlerësimi i modelit më të përshtatshëm për ngritje e qendrave të trajtimit të viktimave nga ngacmimi seksual në Shqipëri"*, organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe UN Women.
- Më 12 prill, Komisioneri u prit në takim nga Presidenti i Republikës.
- Më 18 prill, Komisioneri mori pjesë në takimin konsultues publik të Planit të Veprimit të Strategjisë "Për Edukimin Ligjor të Publikut".
- Më 18 prill, Komisioneri u prit në takim nga Kryetari i Kuvendit.
- Më 19 prill, Komisioneri prezantoi në seancë plenare pranë Kuvendit të Shqipërisë, Raportin e veprimtarisë vjetore për vitin 2017.
- Më 25 prill, Komisioneri mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga IDM dhe UNDP në ambientet e Presidencës, me fokus tolerancën fetare.

- Më 27 prill, një nga punonjësit e KMD-së, mori pjesë në takimin me temë: "*Prezantimi i Raportit Analitik, Financimi i Arsimit Publik Para -Universitar në Shqipëri 2008-2018*" organizuar nga CRCA.
- Më 30 prill, Komisioneri priti në takim, në ambjentet e zyrës së KMD-së, Avokatin e Popullit dhe Komisionerin për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Tema e këtij takimi ishte bashkëpunimi dhe koordinimi i aktivitetit të këtyre institucioneve, në promovimin dhe mbrojtjen sa më efikase të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.
- Më 2 maj, Komisioneri mori pjesë në takimin me temë: "*Punësimi i romëve dhe egjyptianëve përmes programit të nxitjes së punësimit*", të organizuar nga Lëvizja Rinore Egjyptiane & Rome dhe mbështetjen e Fondacionit për Shoqërinë e Hapur (OSFA), ku morën pjesë përfaqësues të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Zyrës së Punës Elbasan, Inspektoriati Shtetëror i Punës, Inspektoriati i Punës në Elbasan.
- Më 11 maj, Komisioneri priti në ambientet e zyrës së KMD-së përfaqësues të disa organizatave të Shoqërisë Civile që mbrojnë të drejtat e pacientëve si "*Together for Life*", "*Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë*", '*Shoqata e Pacientëve me Diabet*", "*Shoqata e Pacientëve me Kancer Gjiri*", dhe përfaqësues të pacientëve të sëmurë me kancer.
- Më 16 maj, Komisioneri i KMD-së, mori pjesë në takimin me temë: "*Prezantimi i Rezultateve të Anketës Rajonale për Romët 2017*", organizuar nga UNDP.
- Më 22 maj, Komisioneri priti në ambientet e zyrës së KMD-së znj. Dunja Mijatoviç, Komisioneren e të Drejtave të Njeriut në Këshillin e Evropës.
- Më datë 4 qershor, Komisioneri mori pjesë në Konferencën Rajonale të Ballkanit Perëndimor, me temë "Të luftojmë së bashku ekstremizmin e dhunshëm. Partneritet për sukses", organizuar në Tiranë me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare dhe Ambasadës Hollandeze.
- Më 6 qershor, Komisioneri priti në një takim përfaqësues të organizatës rome *"Rromano Khan"*, që synon rritjen e bashkëpunimit mes institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile që kanë në fokus mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të Njeriut në përgjithësi dhe atyre të komunitetit Rom dhe Egjiptian në veçanti.
- Më 7 Qershor, Komisioneri priti në takim z. Bernd Borchardt, Kreu i Prezencës së OSBE në Shqipëri, me të cilin diskutuan bashkëpunimin e mëtejshëm për sfidat e mbrojtjes së të drejtave të Njeriut.
- Më 7 Qershor, Komisioneri priti në takim z. Florjan Rojba, Koordinator i Përgjithshëm i Shoqatës Kombëtare Shqiptare i Njerëzve që nuk Dëgjojnë, ANAD.
- Më 8 Qershor, Komisioneri mori pjesë në Prezantimi i Raportit "*Hartëzimi i Popullsisë në Rrezik Pashtetësia në Shqipëri"*, organizuar nga UNHCR.
- Më 12 qershor, Komisioneri mori pjesë në takimin "*Ndal Shfrytëzimit të punës së fëmijëve*", organizuar nga Avokati i Popullit në Bulqizë.
- Më 11-12 qershor, një nga punonjësit e KMD-së mori pjesë në aktivitetin "*Konflikti i Interesit Identifikimi, Trajnimi dhe Zgjidhja*", organizuar nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në bashkëpunim me ASPA.

- Më 21 qershor, një nga punonjësit e KMD-së mori pjesë në Programi Rajonal "*Dhuna ndaj Grave në vendet e Ballkanit dhe Turqisë: Zbatimi i normave, ndryshimi i mendimeve*", financuar nga Komisioni Evropian dhe zbatuar nga UN Women.
- Më 26 qershor, Komisioneri dhe Këshilltari morën pjesë në takimin "*Standardet e Përfaqësimit dhe Pjesëmarrjes së Barabartë në Politikë*", organizuar nga Ambasada Suedeze dhe UN Women.
- Më 26 qershor, një nga punonjësit e KMD-së mori pjesë në "*Përmirësimi i Raportimit në Median Audiovizive për të Ndaluar Diskriminimin dhe Përdorimin e Gjuhës së Urrejtjes*" organizuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.
- Më 26 qershor, Komisioneri dhe stafi morën pjesë në "*Prezantimi i Raportit të vlerësimit për Avokatin e Popullit dhe KMD*" organizuar nga TLAS.
- Më 29 qershor, Komisioneri mori pjesë në takimin e II-të, të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në cilësinë e anëtarit të këtij këshilli. Gjatë takimit u diskutua mbi draft udhëzimin "Për përzgjedhjen e përfaqësuesve të fëmijëve në KKDMF" dhe u prezantua raporti i punës së Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për vitin 2017.
- Më 2-6 korrik, dy nëpunës të KMD-së morën pjesë në trajnimin me temë *"Negociatat e anëtarësimit me Bashkimin Evropian për Kapitujt 23 dhe 24",* të organizuar nga ReSPA-Shkolla Rajonale e Administratës Publike, në Danilovgrad, në Malin e Zi.
- Më 4 korrik, Komisioneri mori pjesë në mbledhjen e dytë të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.
- Më 4 korrik, Komisioneri priti znj. Blerta Çani, drejtore ekzekutive e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, zhvilluar në ambjentet e zyrës së KMD-së.
- Me 4 korrik, një përfaqësues i KMD-së, mori pjesë në workshop-in "Mbrojtja e fëmijëve online" organizuar nga UNICEF Shqipëri, në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të iniciativës #jamisigurtonline.
- Më 5 korrik, Komisioneri, në bashkëpunim me zyrën rajonale Shkodër, organizoi një takim me përfaqësues të shoqërisë civile në qytetin e Shkodrës.
- Më 6 korrik, Komisioneri mori pjesë në Konferencën Shkencore Kombëtare të organizuar nga Fakulteti i Drejtësisë së Universitetit të Tiranës , me temë: "Të drejtat e Njeriut dhe drejtësia gjinore" .
- Më 13 korrik, Komisioneri mori pjesë në prezantimin e gjetjeve të raportit të FSHDPAK ADRF, për punësimin e personave me aftësi të kufizuar (PAK).
- Më 18 korrik, Komisioneri mori pjesë në institucionalizimin e "Aleancës për Dhurimin e Gjakut ", të kryesuar nga Presidenti i Republikës z. Ilir Meta.
- Më 18 korrik, Komisioneri nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, "Together for Life", "Shoqata e Diabetit në Shqipëri" dhe Shoqata "Pacientët me Hepatit", të cilët zhvillojnë veprimtarinë në sferën e mbrojtjes së shëndetit dhe mbrojnë interesat e ligjshme të pacientëve.
- Më 14 gusht, Komisioneri priti në takim aktivistin e "Lëvizjes Rinore Egjiptiane dhe Rome", z. Gentian Sejrani .

- Më 4 shtator, Komisioneri priti në takim të veçantë Shefin e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, zotin Claus Neukirch dhe z. Olsi Dekovi, Zv/Kreu i Zyrës.
- Më 4 shtator, Komisioneri ishte i pranishëm në takimin konsultues publik mbi Planin e Veprimit 2018-2020 të Strategjisë "Për Edukimin Ligjor të Publikut 2018-2023" organizuar nga Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara dhe Save the Children.
- Më 6 shtator, Komisioneri ishte i pranishëm në takimin e organizuar nga Avokati i Popullit me temë "Së bashku në emër të dashurisë", - Dita e Shënjterimit të Nënë Terezës.
- Më 7 shtator, Komisioneri priti në një takim Dr. Johannes Dietrich, Zv. ambasador i Ambasadës Gjermane në Shqipëri, për të biseduar në lidhje me angazhimin e KMD-së në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe antidiskriminimin.
- Më 14 shtator, Komisioneri morri pjesë në tryezën e ngritur nga Avokati i Popullit në lidhje me projekt-rezolutën e Kuvendit "Për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë".
- Më 17 shtator, Komisioneri priti në takim përfaqësuesen e Qendrës "Treja" Ferdiola Tare, përfaqësuesen e shoqatës "Për një të ardhme më të mirë", Flobens Buzhani, aktivistë të organizatës "USHTEN" Anxhela Rakipi dhe Malvina Xhidro, kreun e "Unionit të Egjiptianëve të Shqipërisë" Rexhep Shaka, Ervis Çota kryetari i "Lëvizjes Rinore Egjiptiane & Rome" dhe përfaqësuesen e organizatës "Sfinksi", Anjeza Lile.
- Më 18 shtator, Komisioneri priti në takim të veçantë z. Vedran Ian Kjeldsen, koordinator rajonal për Gjuhën e Urrejtjes dhe departamentit të Antidiskriminimit, pranë Këshillit të Evropës dhe z. Olsi Dekovi, Zv/Kreu i Zyrës, si dhe znj. Edlira Myftari, asistente projekti.
- Më 20 shtator, nëpunës të Zyrës së KMD-së morën pjesë në Trajnimin "Mbrojtja e të drejtave të Pacientëve", të organizuar nga Shoqata Together for Life dhe mbështetur nga USAID. Në këtë trajnim morën pjesë pacientë, përfaqësues të shoqatave të pacientëve, dhe përfaqësues të institucioneve të pavarura si Avokati i Popullit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit.
- Më 28 shtator, Komisioneri zhvilloi një vizitë zyrtare në Republikën e Kosovës, ku u prit në takime të veçanta nga z. Hilmi Jashari, Avokat i Popullit i Kosovës dhe stafi i tij, nga znj. Lirije Kajtazi, LDK, znj. Mexhide Mjaku-Topalli, PDK dhe znj. Teuta Haxhiu, AAK, anëtarë të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione të Kuvendit të Kosovës. Po ashtu, Komisioneri u takua me z. Habit Hajredini, drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë pranë institucionit të Kryeministrit, Ramush Haradinaj.
- Më 3 tetor, Komisioneri mori pjesë në prezantimin e Indexit për Barazinë në Punësim të komunitetit LGBTIQ, të kryer nga The HeadHunter: një nga grupet më të mëdha negociatore të punësimit në disa shtete të rajonit.
- Më 8 tetor, Komisioneri priti në takim dy zyrtarë të lartë të Policisë Suedeze, gjatë vizitës në Shqipëri në kuadër të Programit Ndërkombëtar të Trajnimit për Dhunën me Bazë Gjinore.

- Më 15 tetor, Komisioneri zhvilloi një bashkëbisedim me anëtarë të Aleancës Kundër Diskriminimit të LGBT.
- Më 27 tetor, në ditën kushtuar lirisë Fetare, Komisioneri në bashkëpunim me "Qendrën për Bashkëpunimin Ndërfetar" në Elbasan, organizoi një takim me autoritete fetare dhe shtetërore, drejtues dhe bashkëpunëtorë të Organizatave të Shoqërisë Civile, në qytetin e Elbasanit.
- Më 29 tetor, në mbështetje të iniciativës së Presidentit të Republikës, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me komunitetin egjiptian, realizuan seancën e dhurimit. Kjo iniciativë u përkrah edhe nga gazetarët e Top Channel, të pranishëm për pasqyrimin e aktivitetit në televizion, në një kronikë dedikuar sensibilizimit të institucioneve për dhurim gjaku.
- Më 30 tetor, Komisioneri zhvilloi një takim me 8 deputetë të Bundestagut gjerman, përfaqësues nga të gjitha partitë parlamentare gjermane. Komisioneri shprehu vlerësimin për interesimin e tyre për situatën e diskriminimit në Shqipëri dhe rolin e KMD për promovimin e barazisë dhe tolerancës.
- Më 31 tetor, Komisioneri priti në një takim z. Hilmi Jashari, Avokat i Popullit, i Kosovës dhe stafin e tij. Komisioneri Gajda dhe Avokati i Popullit Jashari diskutuan rreth bashkëpunimit të ngushtë të dy zyrave. Për të implementuar këtë vizion të përbashkët, u nënshkrua një Marrëveshje Bashkëpunimi, e cila synon të forcojë kooperimin në fushat me interes të përbashkët dhe të promovojnë të drejtat e njeriut në të dy vendet.
- Më 31 tetor, Komisioneri ishte i ftuar në tryezën e diskutimit të lidhur me Fenomenin e Largimit të Mjekëve nga Shqipëria organizuar nga shoqata Together for life & Friedrich Ebert Foundation, ku i prezantuan gjetjet e rezultateve te pyetësorit, mbi këtë fenomen.
- Më 14 nëntor, Komisioneri mori pjesë në mbledhjen vjetore të Grupit Këshillimor të Programit të Bashkëpunimit të BE/Coe ROMACTED në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Më 15 nëntor, Komisioneri dhe stafi i KMD-së morën pjesë në Konferencën Rajonale dy ditore: "Shoqëritë tolerante dhe gjithëpërfshirëse në Ballkanin Perëndimor", në Podgoricë, Mali i Zi.
- Më 20 nëntor, një përfaqësues i KMD mori pjesë në tryezën e organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për konsultimin e Udhëzimit të Ministres për hartimin e modelit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale dhe standartet e funksionimit të tyre.
- Më 20 nëntor, përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër ka marrë pjesë në takimin me anëtaret e Parlamentit Rinor të këtij qytetit, ku ka prezantuar misionin e KMD dhe rolin e zyrës rajonale në këtë qytet si dhe aktivitetet e përbashkëta që mund të ndërmarrim në të ardhmen.
- Më 22 nëntor, Komisioneri priti në takim ambasadoren e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, znj. Guusje Korthals Altes, ku u diskutua mbi rolin dhe rëndësinë e Zyrës së Komisionerit për evidentimin e rasteve dhe ofrimin e mbrojtjes nga diskriminimi.
- Më 23 nëntor, Komisioneri dhe Avokati i Popullit dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nënshkruan një marrëveshje

bashkëpunimi institucionale në dobi të qytetarëve, hartuar nga Përfaqësia e OSBE-së në Tiranë.

- Më 4 dhjetor, Komisioneri mori pjesë në aktivitetin e Shoqatës Shqiptare të Mikrofinancës (AMA), që mbledh institucionet financiare kryesore në vend të specializuara në mikro-kreditimin e shtresave më vulnerabël, sipërmarrjes së vogël dhe të fermerëve shqiptare, në bashkëpunim me Qendrën Evropiane të Mikrofinancës, me mbështetjen e Bashkimit Evropian.
- Më 11 dhjetor, Komisioneri mbajti një fjalim për të celebruar 20 vjetorin e Miratimit të Kushtetutës dhe ditëlindjen e institucionit të Avokatit të Popullit.
- Më 12 dhjetor, Komisioneri mori pjesë në seminarin e 4-t, të dialogut Politik për përfshirjen e Komunitetit Rom dhe Egjiptian në vend. Komisioneri inkurajoi palët e interesuara të shfrytëzojnë të gjithë potencialin e KMD për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të komuniteteve vulnerabël.
- Më 13 dhjetor, Komisioneri mori pjesë në seminarin e "PAMECA V", mbi fuqizimin e gruas në Lidership. Komisioneri kërkoi që rritja e përfaqësimit të grave në organet ligjzbatuese, të jetë e garantuar.
- Më 13 dhjetor, Komisionerit mori pjesë në ciklin e seminareve për rolin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Universitetin Beder.
- Më 17 dhjetor, një përfaqësues i KMD-së mori pjesë në trajnimin e organizuar në lidhje me negociatat për Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të drejtat e njeriut", organizuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë, me mbështetjen e GIZ në Tiranë.

Daljet publike të Komisionerit në media

Në mënyrë që publiku të ketë mundësi të njihet dhe informohet sa më shumë me veprimtarinë e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, prononcimet publike në media janë pasqyruar edhe në faqen zyrtare të institucionit në rrjetin social Facebook.

- Më 30 mars, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u shpreh me një deklaratë për shtyp lidhur me debatin për takimet ndërgjegjësuese të LGBT në shkolla ku shprehu shqetësimin lidhur me gjuhën e përdorur.
- Më 24 prill, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka dhënë një intervistë për RTSH Korça, për rëndësinë e edukimit të brezit të ri në lidhje me konceptet e barazisë dhe njohjes së të drejtave themelore, me qëllim eliminimin i ndasive dhe prirjeve diferencuese mes fëmijëve.
- Më 18 maj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u shpreh me një deklaratë për shtyp për ngjarjen e ndodhur brenda dhomave të sigurisë në Komisariatin e Korçës, ku shtetasi Enea Ftoj, 27 vjeç, pjesëtar i komunitetit egjiptian, humbi jetën në rrethana ende të pazbardhura.
- Më 21 maj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në nje interviste për *Zërin e Amerikës*, foli për aspekte të aksesit në shëndetësi dhe mbrojtjes nga diskriminimi për grupet vulnerabël, si dhe rolin e KMD-së për të bërë rekomandime për

institucionet, vendime për të ndëshkuar institucionet për sjelljet diskriminimin, duke bërë edhe avokatinë dhe këshillimin ligjor të qytetarëve.

- Më 13 qershor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, zhvilloi një intervistë në televizionin *Ora News*, ku bisedoi për çështjen e luftës kundër punësimit të fëmijëve, rolin dhe kompetencat e KMD-së, problematika të grupeve vulnerabël dhe nevojën për një bashkërendim institucional për të qënë kampionë të të Drejtave të Njeriut.
- Më 14 qershor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, foli në një prononcim të shkurtër për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, në edicionin e lajmeve të *VOA - Zëri i Amerikës*.
- Më 28 shtator, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dha një intervistë në televizionin *Report Tv* për situatën e diskriminimit në vend dhe rolin e institucionit të KMD-së për promovimin e barazisë.
- Më 29 shtator, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ishte i ftuar në studion e televizionit *Report Tv*, ku foli mbi komunitetet dhe grupet e njerëzve më të diskriminuar dhe mbi masat që merren nga institucioni që ai drejton për parandalimin e tyre.
- Më 5 tetor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dha një intervistë për *Zërin e Amerikës*, mbi dhunën dhe ngacmimin seksual ndaj grave dhe vajzave.
- Më 11 tetor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dha një deklaratë për shtyp për seksionin në shqip të medias shtetërore gjermane Deutsche Welle për aspekte të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për këtë komunitet dhe çfarë mund të bëhet me aktet nënligjor të ligjit për gjendjen civile, për të njohur të drejtat e transgjinorëve.
- Më 30 tetor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u shpreh me një deklaratë për shtyp, ku shprehu shqetësimin për përmbajtjet anti-greke në parullat e shfaqura në ndeshjen Partizani-Skënderbeu, të datës 29/10/2018, në kampionatin shqiptarë Futbollit. Komisioneri garantoi opinionin publik se do të jetë gardian i të Drejtave të Njeriut, siç e parashikon Kushtetuta dhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të promovuar barazinë dhe tolerancën në vend.
- Më 2 nëntor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të një shkrimi u shpreh për "*Pakicat Ballkano-Egjiptiane dhe komunitetet etnikokulturore në Shqipëri*" në një Konference Ndërkombëtare zhvilluar nga Universiteti Elbasanit mbi pakicat kombëtare dhe në specifikë mbi komunitetin Egjiptian.
- Më 19 nëntor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ishte *i ftuar ne studion* e televizionit *Elbasani News*, ku foli për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Më 22 nëntor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ishte *i ftuar në televizionin News 24* për të folur për gjuhën e urrejtjes, një fenomen gjithmonë e në rritje në shoqërinë tonë.
- Më 23 nëntor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, foli për Zërin e Amerikës, mbi firmosjen e një marrëveshje bashkëpunimi institucionale në dobi të

qytetarëve sipas një marrëveshje të hartuar me kujdes nga OSBE ndërmjet Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- Më 6 dhjetor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ishte i ftuar në programin "Mirëmëngjes Shqipëri", në *Televizionin Shqiptar*. Komisioneri foli mbi gjuhën e urrejtjes (Hate Speech), nevojën për një përkufizim të termit si edhe mbi nevojën e rritjes së ndërgjegjësimit si të publikut ashtu edhe të personaliteteve publike në median televizive dhe atë online.
- Më 13 dhjetor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, publikoi *artikullin* me titull "*Kushtetuta Shqiptare dhe Efektiviteti në Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut*", në Gazetën Panorama.

Iniciativa të Zyrës së KMD

Më datë 29 tetor 2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi organizoi Konferencën e tretë Rajonale të Institucioneve të Barazisë, me temë: *"Pavarësia e Institucioneve të Barazisë",* në ambjentet e Pallatit të Brigadave, Tiranë. Konferenca pjesërisht u mbështet financiarisht nga Prezenca e OSBE-së, në Shqipëri.

Konferenca u organizua në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve të Barazisë të Evropës Jug-Lindore, të nënshkruar në vitin 2016. Referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve të Barazisë të Evropës Jug-Lindore, mbledhjet rajonale të Institucioneve të Barazisë organizohen çdo vit, në vende të ndryshme pritëse. Konferenca e parë Rajonale u organizua në vitin 2016 nga Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë i Serbisë, në Beograd dhe në vitin 2017 nga Ombudsman për Barazinë Gjinore i Republikës së Kroacisë, në Zagreb. Konferenca e Tretë Rajonale e Institucioneve të Barazisë, u zhvillua në vijim të traditës për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta vjetore.

Konferenca e Tretë Rajonale mblodhi organet e barazisë së Evropës Juglindore nga Maqedonia, Serbia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, si dhe të ftuar të veçantë, Avokati i Popullit të Kosovës dhe Avokaten e Popullit të Shqipërisë. Konferenca u përshëndet nga Znj. Vasilika Hysi, Nënkryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Kryetare e Nënkomisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Ambasadori Bernard Borchardt, Shefi i Misionit të OSBE-së në Shqipëri dhe Z. Tamás Kádár, Drejtues i Ekipit Ligjor dhe Politikave, në EQUINET. Të pranishëm ishin gjithashtu përfaqësues nga institucione të ndryshme kombëtare Shqiptare dhe organe të tjera të pavarura, si dhe shumë organizata ndërkombëtare për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, që veprojnë në Shqipëri.

Tema e Konferencës "*Pavarësia e Institucioneve të Barazisë*", u bazua në dy standartet të reja të vendosura në kuadrin e Rekomandimit Nr. 2 të Politikave të Përgjithshëm të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Tolerancës – ECRI, të Këshillit të Evropës si dhe Rekomandimit të Komisionit të Bashkimit Evropian "Mbi Standartet për Organet e Barazisë", të cilat përbëjnë një zhvillim mjaft të rëndësishëm për institucionet e barazisë.

Qëllimi i Konferencës së tretë Rajonale të Institucioneve të Barazisë të Evropës Jug-Lindore ishte diskutimi mbi këto standarte të e reja të miratuara në nivel evropian dhe të nxitja e bashkëpunimit rajonal ndërmjet Institucioneve të Barazisë.

Nga diskutimet e përfaqësuesve të organeve të barazisë pjesëmarrëse në Konferencë, doli se disa nga çështjet apo problemet e përbashkëta me të cilat ballafaqohen organet e barazisë, në ushtrimin e mandatit dhe kompetencave të tyre në mënyrë të pavarur, rezultuan si më poshtë:

- Organet e Barazisë në Evropën Juglindore janë në proces të rishikimit të legjislacionit të tyre kombëtar për mbrojtjen nga diskriminimi, duke pasqyruar ndër të tjera edhe aspektin e tyre institucional;
- Organet e Barazisë, në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, përballen me problemin e burimeve të pamjaftueshme financiare, një fakt që shkel ushtrimin e pavarur të mandatit të tyre dhe kompetencat që këtyre institucione u janë dhënë nga legjislacioni i tyre kombëtar;
- Organet e Barazisë nuk kanë asnjë garanci lidhur me miratimin e buxhetit të tyre dhe Parlamentet nuk kanë kufizime në reduktimin e buxhetit ndaj këtyre institucioneve. Shpesh Organet e Barazisë vuajnë nga procedura kufizuese në aktivitetet operacionale të shpenzimit të burimeve të tyre financiare;
- Organet e barazisë përballen me kufizime administrative ose kufizime të tjera burokratike, të tilla si pamundësia për të përcaktuar vetë mënyrën e organizimit dhe strukturën institucionale, miratimin e strukturës së këtyre institucioneve nga organet e tjera ose aspektet që lidhen me pagat dhe kategoritë e punonjësve, të cilat ndikojnë në pavarësinë administrative të këtyre institucioneve;
- Organet e Barazisë, në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, përballen me kufizime ose presione të tillë si, kontrolli i veprimtarisë së këtyre institucioneve me detyrimin që raportet vjetore të veprimtarisë së tyre të miratohen nga organet e tjera shtetërore;
- Organet e barazisë përballen me problemet e mungesës së kapaciteteve dhe ambienteve të mjaftueshme dhe të përshtatshme të infrastrukturës, aspekte të cilat jo vetëm që ndikojnë në pavarësinë e tyre, por edhe të drejtën e qytetarëve për të pasur qasje efektive në këto institucione.

Më 19 dhjetor, Komisioneri thirri në takim konsultues përfaqësues të organizatave jo qeveritare dhe të shoqërisë civile, me qëllim diskutimin dhe marrjen e mendimeve për ndryshime të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", përpara propozimit të tyre në Kuvendin e Shqipërisë. Takimi u zhvillua në ambientet e Hotel "Tirana International".

Gjatë vitit 2018, Komisioneri inicioi hartimin e një website të ri zyrtar, të pasur me informacion dhe lehtësisht të aksesueshëm për publikun, www.kmd.al .

Në krye të faqes, është i dukshëm, numrin jeshil pa pagesë: **08000606,** i cili synon t'i vijë në ndihmë publikut dhe ankuesve, duke kontaktuar drejtpërdrejtë me Drejtorinë e Pritjes së Ankesave.

Raportime dhe kontribute të Komisionerit

Gjatë vitit 2018, KMD ka hartuar raporte, informacione dhe kontribute, konkretisht:

- Informacion mbi pyetësorin për zbatimin e rekomandimit të Komitetit të Ministrave CM/(2010) 5, mbi masat për të luftuar diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe Identitetit gjinor, me shkresën nr. 691/1 Prot., datë 18.05.2018;
- Kontributi i KMD-së lidhur me takimin e X-të të nënkomitetit "*Drejtësi, Liri dhe Siguri",* me shkresën nr. 663/1 prot., date 01.06.2018.
- Kontributi i Komisionerit mbi hartimin e Raportit Periodik Kombëtar mbi zbatimin e Konventës së OKB-së "*Për të Drejtat e Fëmijës*";
- Informacion mbi raportimin për zbatimin e rekomandimeve të Konventës së OKB-së "*Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj Grave*" (CEDAW), i hartuar në bazë të rekomandimeve specifike, bazuar në vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CEDAW mbi zbatimin e Konventës. Shkresa nr. 125/1 datë 30.01.2018 lidhur me masat e marra nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me Planin e Veprimit për 2018-2020 të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit.
- Kontributi i KMD-së në kuadër të Takimit të 10^{të} të Nënkomitetit të Inovacionit, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale.
- Kontributi i KMD-së në kuadër të Takimit të 9të të Komitetit të Stabilizim Asociimit.
- Kontributi i KMD-së në kuadër të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2019, Kapitulli 19 "Politikat Sociale dhe Punësimi".
- Kontributi i KMD-së në kuadër të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2019, Kapitulli 23 "Gjyqësore dhe të Drejtat Themelore".
- Kontributi i KMD-së në kuadër të Raportit të pestë Periodik Shtetëror të Republikës së Shqipërisë për Komitetin për të Drejtat e Fëmijës.
- Kontributi i KMD-së në kuadër të Raportit Periodik Kombëtar mbi zbatimin e Paktit të OKB-së "Për të drejtat civile dhe politike".
- Raportime periodike të KMD-së, në kuadër të zbatimit të Planit të Masave për Rekomandimet Afatshkurtra për Kapitullin 23, të Komisionit Evropian, për vitin 2018.
- Kontributi i KMD-së në kuadër të Karta Sociale Evropiane.
- Kontributi i KMD-së në kuadër të Raportit mbi Lirinë e Besimit, 2018, të Departamentit Amerikan të Shtetit.
- Kontributi i KMD-së në kuadër të Raportit për të Drejtat e Njeriut, 2018, të Departamentit Amerikan të Shtetit.
- Kontributi i KMD-së mbi diskriminimin racial, ksenofobinë dhe format e intolerancës, në kuadër të Sesionit të 39-të, të Këshillit për të Drejtat e Njeriut, pranë OKB-së.

Seanca dëgjimore në Kuvend

Gjatë vitit 2018, Komisioneri ka qenë i pranishëm në disa seanca dëgjimore në Kuvend:

- Më 15 mars, Komisioneri ka paraqitur përpara Komisionit të ligjeve, Raportin Vjetor për veprimtarinë e KMD, gjatë vitit 2017
- Më 21 mars, Komisioneri mori pjesë në seancë dëgjimore publike me grupet e interesit dhe më përfaqësues të institucioneve shtetërore, me rastin e Ditës Botërore të Sindromës Down, zhvilluar nga Komisioni Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.
- Më 20 qershor, Komisioneri mori pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni për Punën Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, mbi diskutimin e projekt-ligjit *"Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"*.
- Më 14 nëntor, përfaqësues të Zyrës së KMD morën pjesë në seancën e diskutimeve në Kuvend të zbatimit të mekanizmave ndërinstitucionalë.
- Më 12 dhjetor, Komisioneri mori pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, së bashku me Nënkomisionin për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas, Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut zhvilluan dhe grupet e interesit, të cilët diskutuan mbi zbatimin e legjislacionit për sa i përket abortit selektiv me bazë gjinore. Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi ngriti shqetësimin e mangësive në shifra, raporte, të dhëna nga institucionet dhe organet shtetërore.

Raportime nga Bashkitë e vendit

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar informacion për 61 Bashki mbi emërimet e zëvendëskryetarit/zëvendëskryetaret e bashkisë dhe emërimet e administratorëve/administratoreve në njësitë administrative.

Referuar nenit 15, pika 1 të Ligjit nr. 9970/2008 "*Për barazinë gjinore në Shqipëri*", theksohet se përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur: " *a) sigurohet përfaqësim në masën mbi 30 për qind për secilën gjini, përfshirë edhe në organet e tyre drejtuese"*.

Një ndër detyrat e Kryetarit të bashkisë, bazuar në nenin 64, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", është zbatimi dhe respektimi i barazisë gjinore në emërimet e zëvendëskryetarit/zëvendëskryetaret e bashkisë dhe në emërimet e administratorëve/administratoreve të njësive administrative/lagjeve.

Përsa me sipër, në mbështetje të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", germës a), pika 1, të nenit 15 të ligjit nr. 9970/ 2008 "*Për barazinë gjinore*", si dhe germa e) dhe ë), të nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", është kërkuar informacion lidhur me pikat e mëposhtme:

- Numrin e zëvendëskryetarëve/zëvendëskryetareve të emëruar në bashkinë që ju drejtoni së bashku me emrat përkatës dhe gjininë.

- Numrin e njësive administrative në varësi të bashkisë që ju drejtoni me emrat përkatës dhe gjininë e administratorëve/administratoreve për secilën njësi administrative.

Gjithashtu, mbështetur në germa f) dhe k), të nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", është kërkuar informacion lidhur me:

- Numrin e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërive tregtare në pronësi të bashkisë, së bashku me emrat dhe gjininë përkatëse.
- Numrin e drejtuesve të ndërmarrjeve e të institucioneve në varësi, së bashku me emrat dhe gjininë përkatëse.
- Numrin e nëpunësve vendorë për barazinë gjinore, së bashku me emrat dhe gjininë përkatëse.

II.24. Bashkëpunime të KMD

KMD - Anëtar i EQUINET (Rrjetit Evropian të Organeve të Barazisë)

Stafi i KMD është përfshirë në shtatë grupe pune të rrjetit EQUINET gjatë vitit 2018, duke vlerësuar pjesëmarrjen si në aspektin e rritjes së kapaciteteve profesionale ashtu edhe në shkëmbimin e praktikave ndërmjet organeve të barazisë në vende të ndryshme të Europës, konkretisht në:

1. Grupin e Punës për legjislacionin e barazisë
2. Grupin e Punës për komunikimin, strategji dhe praktika
3. Grupin e Punës për barazinë gjinore
4. Grupin e Punës për hartimin e politikave
5. Grupin e Punës për çështjet gjyqësore strategjike
6. Grupin e Punës për vlerësimin e projekteve
7. Grupin e Punës mbi standartet e Organeve të Barazisë

Gjatë periudhës së raportimit, stafi i KMD ka marrë pjesë në aktivitetet e Equinet, si:

- Në 6 mars, 2 përfaqësues të KMD-së, morën pjesë në mbledhjen e parë të grupit të Punës "Communication Strategies and Practices", zhvilluar në Vilinus, Lituani.
- Në datën 20 Prill, anëtar të stafit të KMD-së morën pjesë në mbledhjen e Grupit të Punës "*Policy Formation*" të EQUINET, e cila kishte në fokus temën "*Institucionet e Barazisë që adresojnë gjuhën e urrejtjes*".
- Me datë 8 maj, një përfaqësues i KMD-së, mori pjesë në Takimin e I-të, të Grupit të Punës për Legjislacionin e Barazisë, në kuadër të Equinet, i cili u zhvillua ne Bruksel. Në takim u diskutua mbi diskriminimin për shkak të moshës.
- Me datë 1 qershor, një përfaqësues i KMD mori pjesë në Konferencën "*Investimi për Barazi*". Konteksti i kësaj Konference ishte për të adresuar sfidat e barazisë, për të diskutuar mbi zgjidhjet në nivel evropian dhe për të identifikuar rolin që institucionet e barazisë mund të luajnë. Një ditë më parë, kësaj konference i parapriu një tryezë diskutimi mbi legjislacionin europian për barazi dhe mosdiskriminim, me temë: "*Draft Direktiva Horizontale - Hapat e mëtejshme për të avancuar debatin*". Bashkë-organizatorët e kësaj tryeze mbi draft – direktivën horizontale, Zyra e Komisionerit të Lartë të të Drejtave të

Njeriut të Kombeve të Bashkuara - Zyra Rajonale Evropiane dhe Equinet publikuan një deklaratë të përbashkët që thekson rëndësinë për një miratim sa më të shpejtë të kësaj Direktive.

- Më datë 27-28 qershor, dy përfaqësues të KMD-së morën pjesë në seminarin me temë "Trajtimi i diskriminimit të të rinjve, për shkak të moshës: Ndërtimi i urave ndërmjet Organeve të Barazisë dhe Organizatave Rinore", organizuar nga Equinet dhe Forumi Rinor Evropian, i cili u zhvillua në Lubjanë Slloveni.
- Më 26 shtator, një përfaqësues i KMD mori pjesë në mbledhjen e grupit të punës "Gender Equality", të Equinet, me fokus "Edukimi gjinor në shkolla" dhe "Dhuna me bazë gjinore në shoqëri".
- Më 3 tetor, një përfaqësues i KMD mori pjesë në trajnimin e Equinet&ENNHRI, me fokus "Funksionimin e mekanizmave monitorues të Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar".
- Më datë 11 tetor, dy përfaqësues të KMD-së morën pjesë në Takimin e II-të të Grupit të Punës për Legjislacionin e Barazisë, në kuadër të Equinet, i cili u zhvillua ne Maltë. Në takim u diskutua mbi dokumentin "Diskriminimi për shkak të moshës". Pjesë e diskutimeve ishin përfshirja e EQUINET në monitorimin e vendimeve të GJEDNJ dhe mundësia që EQUINET të ndërhyjë si palë e tretë pranë GJEDNJ.
- Më 7 nëntor, Komisioneri mori pjesë në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të EQUINET - Rrjetit Evropian i Organeve të Barazisë, që u zhvillua në Bruksel.
- Më 20 nëntor, Komisioneri mori pjesë në seminarin për trajtimin e Gjuhës së Urrejtjes, organizuar nga Equinet, i cili u zhvillua në Romë, Itali.
- KMD ka përgatitur dhe dërguar Equinet një përmbledhje në anglisht të Raportit mbi aktivitetin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2017, i cili është publikuar në faqen zyrtare të Equinet[35] dhe në Buletinin Informativ, si dhe ka përditësuar të dhënat e institucionit.
- Më 7 nëntor, Komisioneri mori pjesë në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të EQUINET (Rrjetit Evropian i Organeve të Barazisë), që u zhvillua në Bruksel.
- Më 20 Nëntor, Komisioneri mori pjesë në seminarin e Equinet për trajtimin e Gjuhës së Urrejtjes, në Romë.

Pjesëmarrja në grupe pune ndërinstitucionale

Përfaqësues të stafit të KMD janë anëtarë të Grupit Ndërinstitucional të Punës, në kuadër të kapitullit Kapitullit 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore", për çeljen e negociata për anëtarësim në BE. Institucion lideri procesit është Ministria e Drejtësisë.

Përfaqësues të stafit të KMD janë anëtar të Grupit Ndërinstitucional të Punës, në kuadër të Kapitullit 2&19, për çeljen e negociata për anëtarësim në BE. Institucion lider i procesit është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Komisioneri merr pjesë si i ftuar i përhershëm në Këshillin Kombëtar të Integrimit Europian.

Pjesëmarrje e përfaqësuesit të KMD si anëtare e Mekanizmit Koordinues të Vendit (MKV).

[35] Publikuar në faqen zyrtare të Equinet , në link: http://www.equineteurope.org/Albania-Annual-Report

II.25. Projekte të KMD

Projekti i Përbashkët i BE-KiE "Rritja e efektivitetit të sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe antidiskriminimit"

Projekti ishte një program i përbashkët i BE-së dhe Këshillit të Evropës për të rritur efektivitetin e sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe anti-diskriminimit. Grupet kryesore të synuara janë Avokati i Popullit, Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Në kuadër të projektit u hartua *"Plani Strategjik 2018-2021 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi"* dhe Plani i Veprimit për vitin 2018, me mbështetjen financiare dhe ekspertizën e ofruar në kuadër të këtij projektit të përbashkët BE-KiE *"Rritja e efektivitetit të sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe antidiskriminimit"* dhe "Strategjia e Komunikimit të KMD" . Është ndërtuar një program i ri i hedhjes së të dhënave dhe ndjekjen në vazhdimësi të çështjeve, *"Therefore"*.

Aktivitete në kuadër të projektit

- Në muajin prill-maj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, organizoi "*Ditët e Hapura kundër diskriminimit*" në Korçë, Gjirokastër, Shkodër, Kukës dhe Fier.
- Gjatë periudhës janar-mars 2018 u organizuan 12 "*Seminare Ndërgjegjësimi për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", në rajone të ndryshme të Shqipërisë, konkretisht në Durrës, Elbasan, Lushnje, Fier, Vlorë, Lezhë, Shkodër, Korçë, Kukës, Berat, Gjirokastër, Tiranë. Në këto seminare ndërgjegjësimi, përfaqësues të Komisionerit morën pjesë rolin e mbështetësit të konsulentes së projektit. Përfaqësuesi i KMD-së në këto seminare është menduar që të mbështesë konsulenten, në mënyrë që tek pjesëmarrësit të mos synohet vetëm informimi dhe ndërgjegjësimi për çështje te anti-diskriminimit por edhe krijimi i kontakteve me institucionin e KMD-së. Target grupe ishin: - Punonjësit e sektorit të arsimit; -Punonjësit e bashkive që mbulojnë shërbimet sociale, mbrojtjen e vajzave dhe grave nga dhuna ne bazë gjinore, dhe Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve; - Punonjësit e Zyrave Rajonale te Punës; - Përfaqësues të OJF-ve lokale që punojnë me grupet e rrezikuara nga forma të ndryshme diskriminimi.
- Më 24-25 janar, Stafi i KMD-së, mori pjesë në trajnimin me temë:" *Rregullorja dhe proçedurat e brendshme të KMD-së*", organizuar nga Këshilli i Europës.
- Stafi i Kmd-së ka mare pjesë në Platformën HELP- Human Rights Education for Legal Professionals, në 2 kurse online "*Azili dhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut*" dhe "*Biznesi dhe të drejtat e Njeriut*", e cila u finalizua në Shkurt.
- Më 22 shkurt, Stafi i KMD-së, mori pjesë në trajnimin me temë: "Biznesi dhe të Drejtat e Njeriut", organizuar nga Këshilli i Europës.
- Më 24 maj, një punonjës i KMD-së mori pjesë në aktivitetin "*Takimi i Dytë i Komitetit Drejtues të Instrumentit Horizontal*", të organizuar nga Këshilli Europës.
- Më datat 26 shkurt- 2 mars pjesëtare të stafit të KMD-së morën pjesë në vizitë studimore, në kuadër të Programit të Përbashkët BE – KiE, zhvilluar në Vienë, Austri.

Sipas axhendës, u vizituan: Ludwig Boltzmann Institute of Human Rights, Austrian Ombudsman Board, Chamber of Labor, Austrian Ombud for Equal Treatment, Equal Treatment Commission, Service Centre of the Ministry of Social Affairs, The Ombudsman for Persons with Disabilities, Vienna Anti-Discrimination Unit for Lesbian, Gay and Transgender People.

- Nga data 7 deri në 9 maj Komisioneri dhe një pjesë e stafit morën pjesë në një vizitë studimore zhvilluar në Bruksel, organizuar nga Këshilli i Evropës.
- Më 19-20 mars, Stafi i KMD-së, mori pjesë në trajnimin me temë: "Strategjia e Komunikimit të KMD ", organizuar nga Këshilli i Evropës.
- Më 11 dhe 12 prill, një nga punonjësit e KMD-së, mori pjesë në "*Ditë të Hapura kundër Diskriminimit*", në Kukës dhe Fier, në kuadër të Projektit të Përbashkët të BE-KiE "*Rritja e efektivitetit të sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe diskriminimit"*.
- Më 28 maj, stafi i KMD-së mori pjesë në Konferencën finale të EU-KiE Projektit të përbashkët "*Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Shqiptar të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Kundër Diskriminimit*", organizuar nga Këshilli i Evropës.
- Më 28 maj, Komisioneri, mori pjesë në "*Takimi i pestë i Komitetit Drejtues të Projektit*" organizuar nga Këshilli i Europës.
- Më 28 maj, Komisioneri dhe Avokati i Popullit firmosën një memorandum bashkëpunimi, të lehtësuar nga Këshilli i Evropës.

Projekti UNICEF për mbështetjen e Tri Zyrave Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në identifikimin dhe adresimin e çështjeve të diskriminimit kundër fëmijëve

Ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminim dhe UNICEF është nënshkruar një marrëveshje partneriteti me qëllim mbështetjen financiare për Tri Zyra Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me qëllim fuqizimin institucional të KMD, veçanërisht në identifikimin dhe adresimin e çështjeve të diskriminimit kundër fëmijëve.

Bazuar në këtë projekt, KMD ka vazhduar funksionimi i zyrave pilot në tri qytete duke synuar:

- Rritjen e vizibilitetit dhe pranisë së Zyrës së Komisionerit në një zonë më të madhe gjeografike, përtej kryeqytetit;
- Rritjen e numrit dhe cilësisë së ankesave për diskriminim të supozuar;
- Zvogëlimi i shpenzimeve e qytetarëve për t'iu qasur KMD-së, si dhe sigurimi i mbështetjes së drejtpërdrejtë, në kohë, për banorët e këtyre rajoneve;
- Të shërbejë si ndërlidhës me autoritetet lokale, shoqërinë civile, universitetet dhe institucionet e tjera arsimore dhe aktorë të ndryshëm në rajone;
- Shpërndarjen e informacionit dhe rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me rastet e diskriminimit;
- Sigurimi i monitorimit në bazë të diskriminimit dhe mbledhja e të dhënave dhe informacionit të nevojshëm.

Programi i Shkëmbimit i mbështetur nga GIZ

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është ftuar të marrë pjesë në kuadër të Programit të Shkëmbimit, i cili mbështetet nga GIZ- Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

GIZ implementon nën-projekte për të arritur qëllimet e Fondit te Hapur Rajonal për Evropën Jug-Lindore -Projekti i Reformës Ligjore. Objektiv i këtij projekti është përmirësimi i bashkëpunimit rajonal për implementimin e Kapitujve 23 dhe 24 të *Acquis*. Një nga nën-projektet ka në fokus temën e anti- diskriminimit. Në kuadër të këtij nën-projekti, ky Program Shkëmbimi i GIZ, konsiston në mbështetjen e bashkëpunimit dhe ndarjes së eksperiencave /përvojave të Institucioneve të Barazisë të Ballkanit Perëndimor. Mënyra mbi të cilën institucionet e barazisë në rajon mund të mësojnë nga njëri-tjetri është shkëmbimi i punonjësve të këtyre institucioneve për një periudhe kohore dy-javore, me qëllim të qënurit pjesë në veprimtarinë/ punët e përditshme dhe ndjekja e tyre nga afër, i cili do të ekspozonte praktikat më të mira dhe mundësitë për të mësuar dhe shkëmbyer eksperiencat.

KMD dërgoi një punonjës pranë Ombudsman për Aftësinë e Kufizuar në Republikën e Kroacisë, për një periudhë dy-javore. Ky institucion është propozuar nga KMD për arsye se legjislacioni në fushën e anti-diskriminimit është i ngjashëm dhe mbi të gjitha, marrjen e eksperiencës nga ky institucion për monitorimin e Konventës së OKB "*Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*", duke qenë se kjo është një temë e veçantë interesi për KMD në këtë moment.

Gjithashtu, në kuadër të këtij Programi, KMD ka pritur një punonjëse nga Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë të Serbisë.

II.26. Marrëveshje bashkëpunimi

1. Më datë 28 maj 2018, nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit mes Avokatit të Popullit (AP) dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD). Objekti i kësaj marrëveshje është institucionalizimi i marrëdhënieve midis KMD dhe AP për sigurimin e ndihmës reciproke në drejtim të lehtësimit të shkëmbimit të informacionit e bashkëpunimit midis dy institucioneve, në kuadër të garantimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe më veçanërisht në fushën e të drejtës për mosdiskriminim dhe barazi në ligj dhe para ligjit, dhe promovimin e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individëve. Kjo marrëveshje u nënshkrua në kuadër dhe ekspertizën e Projektit të Përbashkët BE-KiE "Rritja e efektivitetit të sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe antidiskriminimit"
2. Në praktikë kjo marrëveshje është duke u zbatuar jo vetëm në kuadër të bashkërendimit të iniciativave të përbashkëta, por edhe nëpërmjet përcjellës reciprokë së ankesave të bëra nga individët tek institucioni që ka kompetencën.
3. Më datë 23 nëntor 2018, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për

të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kjo marrëveshje u nënshkrua në kuadër të frymës së bashkëpunimit midis institucione të pavarura kombëtare Qëllimi i kësaj marrëveshje është forcimi i bashkëpunimit institucional me qëllimin e garantimin në mënyrën më të mirë të të drejtave të qytetarëve, sipas kompetencave që secili nga këto institucione ka. Kjo marrëveshje u mbështet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

4. Më datë 18 korrik, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe tre shoqatave që zhvillojnë veprimtarinë në sferën e mbrojtjes së shëndetit, Shoqata "Together for Life", Shoqata e Diabetit në Shqipëri dhe Shoqata "Pacientët me Hepatit".

II.27. Programi i transparencës

Gjatë vitit 2018, në Programin e Transparencës pranë regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve janë regjistruar 22 kërkesa, ku ju është dhënë përgjigje me shkresë ose e-mail.

Në përgjithësi është kërkuar informacion në lidhje me ecurinë e ankesave dhe tërheqjen e një kopje të dosjes së tyre.

Gjatë kësaj periudhe, pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun janë realizuar mesatarisht 500 (pesëqind) telefonata.

KAPITULLI III

ASPEKTE TË SHËRBIMEVE

III.1. Veprimtaria e Burimeve Njerëzore për vitin 2018

Është miratuar ndryshimi i strukturës, organikës dhe numrit të punonjësve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me Vendimin e Kuvendit Nr.88, datë, 23.07.2018 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 34, datë 20. 05.2010 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të vendeve të punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi "*. Me miratimin e këtyre ndryshimeve, organika e institucionit tonë është rritur nga 23 në 34 punonjës të cilët janë të organizuar në 5 drejtori dhe kabineti i Komisionerit. Si rrjedhojë e kësaj është kryer procesi i ristrukturimit të institucionit.

Në përputhje me planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, janë zhvilluar 2(dy) procedura konkurrim për pozicione të lira pune, bazuar në ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", për pozicionet e punës:

Specialist në Drejtorin e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

Janë hartuar kontratat për punonjësit e zyrave rajonale Shkodër, Korçë dhe Gjirokastër, janë kryer vlerësimet e performancës së punonjësve, si dhe janë dorëzuar pranë ILDKPKI- së deklaratat e pasurive të subjekteve që mbartin detyrimin e deklarimit sipas parashikimeve ligjore.

Është punuar ne vazhdimësi për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit të Zyrës së Komisionerit. Stafi i KMD-së ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme si, trajnime të organizuara nga Departamenti i Administratës Publike, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), Këshilli i Evropës etj. Në trajnimin e organizuar nga Departamenti i Administratës Publike janë trajtuar tema si përkufizimet, parimet dhe institutet më të rëndësishme të Kodit të Ri të Procedurave Administrative.

Specialisti i Burimeve Njerëzore dhe specialist i Financë-Buxhetit kanë marrë pjesë në disa trajnime, si personat përgjegjës të punës me "Sistemin e menaxhimit të Regjistrit Qendror të Personelit (HRMIS)", që menaxhojnë dosjet e personelit dhe llogaritin pagën në mënyrë elektronike për të gjithë nëpunësit. Gjithashtu specialisti i Burimeve Njerëzore ka marrë pjesë në trajnimin në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesave.

Punonjësit e KMD janë përfshirë në një proces trajnimesh, pjesëmarrje në grupe pune, brenda e jashtë vendit, të cilat mundësuan shkëmbimin e eksperiencës dhe njohjen me praktikat më të mira.

III.2. Veprimtaria e IT

Është implementuar sistemi i menaxhimit të të dhënave.
Është ndërtuar portali i institucionit, i cili, tashmë është funksional në faqen www.kmd.al

III.3. Menaxhimi i burimeve financiare

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), në zbatimin të buxhetit të vitit 2018, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010, *"Për mbrojtjen nga diskriminimi"*. Komisionerit, në lidhje me performancën financiare buxhetore, ka vepruar me korrektësi, në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06. 2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar ; të ligjit "Për Buxhetin e vitit 2018", i ndryshuar, në vijim Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 2 datë 06. 02. 2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar,

III.4. Programi "Planifikim, Menaxhim dhe Administrim"

Buxheti i akorduar për këtë program është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit: Organizimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme për mirëfunksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; përafrimi dhe harmonizimi i legjislacionit në fushën e zbatimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit me legjislacionin e vendeve të tjera të bashkimit europian; sigurimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues dhe hartimi i strategjive për realizimin e këtij synimi; vendosja e marrëdhënjeve dhe hartimi marrëveshjeve të bashkëpunimit me të gjithë aktorët që ndikojnë në zbatimin e kërkesave ligjore në fushën e zbatimit të parimit të barazisë; nxitja dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve që kanë interes të drejtpërdrejtë si dhe të gjithë shoqërisë mbi mundësitë e zbatimit të parimit të mësipërm, për të garantuar maksimalisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Në zbatim të ligjit "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2018'', raportojmë mbi performancën e produkteve të buxhetit për periudhën janar-dhjetor 2018, sipas modeleve standarte të monitorimit. Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është akorduar një fond prej *43.878,02 (në mijë lekë)* për vitin 2018. Totali i vlerës së akorduar duke përfshirë edhe fondin e donatorëve prej *2.169,62 (në mijë lekë)* përbëhet nga:

Fondi i Pagave:	21. 000	*mijë lekë*	*(zëri 600)*
Fondi i Sigurimeve Shoqërore:	3. 700	*mijë lekë*	*(zëri 601)*
Fondi për Shpenzime Operative:	10. 758, 4	*mijë lekë*	*(zëri 602-606)*
Fondi për Investime:	1. 000	*mijë lekë*	*(zëri 231)*
Fondi i Donacioneve:	2. 169, 62	*mijë lekë*	*(zëri 600,602)*

Nga fondi i planifikuar për 12-mujorin që është *39.059,5 (në mijë lekë)*, për periudhën e raportuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka realizuar vlerën buxhetore dhe jashtë buxhetore *35.779,63 në mijë lekë* ose 91,61 % e buxhetit total mujor të akorduar.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore, (zëri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar me Vendimin e Kuvendit Nr. 34 datë 20. 05.2010 *"Për Miratimin e Strukturës, Organikës dhe Kategorizimit të Pozicioneve të Punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* numri mesatar i punonjësve është realizuar 22 vetë, nga 23 vetë të miratuar.

Nga fondi i pagave, sigurimeve shoqërore dhe shpërblimeve të planifikuar prej *24.700 (në mijë lekë)* për këtë periudhë, është realizuar *24.567,95 (në mijë lekë)* për paga dhe për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore ose 99,47 % e fondit mujor të planifikuar në të dy zërat bashkë.

Fondi për shpenzim investime (zëri 231): nga vlera e përgjithshme prej *1.000 (në mijë lekë)* për periudhën e raportuar, është realizuar vlera prej *684,00 (në mijë lekë)* ose 68,4 %, e fondit të vitit të planifikuar në 12-mujor.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602-606); për 12-mujorin e vitit 2018, është planifikuar në vlerën *10.758,4 në mijë lekë*. Për periudhën respektive është realizuar vlera prej *8.323,23 (në mijë lekë)* ose 77,37 %, e fondit të vitit të planifikuar.

Fondi i Donacioneve (zëri 602); për vitin 2018, është në vlerën *2.601,1 (në mijë lekë)*. Për periudhën respektive është realizuar në projektin me Këshillin e Evropës (është mbyllur Faza II) dhe me UNICEF (Qershor-Shtator), vlera prej *2.204,45 (në mijë lekë)* ose 84,75 %, e fondit të planifikuar.